



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

Pranuar - Prilbjen Me Data 08-09-2026			
Nr. Llogarit Org. Broj	Numri Broj	Titulli i Projeqti	Vlera Vendimost
01-	060/07-	893	



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 të Ligjit Nr.03/L - 040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28 / 15, Qershor 2008), dhe të Nenit 42, paragrafi 42.3 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011; Nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

FTESË

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e VIII të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, që do të mbahet me datë **15.09.2026 (e Martë)**, në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit në objektin e vjetër të komunës së Vitisë. Për këtë mbledhje kryesuesi propozon këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e shtatë e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për projekt buxhetin e Komunës së Vitisë 2027-2029.
3. Kërkese për shqyrtimin dhe rekomandimin e propozim-vendimit për vënie në shqyrtim publik të projekt Hartës Zonale komunale të Vitisë 2026-2034.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e Vendimit Nr. 01-110/05-490, të datës 04.05.2026, për kthimin e mjeteve buxhetore në kategorinë ekonomike të investimeve kapitale.

Viti, më 08.09.2026

Me respekt!
Kryesuesi i Kuvendit
Bekim Azizi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

NGA MBLEDHJA E SHTATË E KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **14.08.2026 (e Premte)**, në zyrën e kryesuesit të Kuvendit Komunal të Vitisë, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z.Bekim Azizi (kryesues i Kuvendit Komunal), z.Illir Zuka, z.Basri Aliu, zn.Zejnepe Osmani, z.Jakup Demiri, znj.Elsa Jahija, zn.Liridona Bislimi. Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive. Pasi u konstatua se janë prezent të gjithë anëtarët e KPF-së dhe ka kourum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Përshëndetje për nënkryetarin e Komunës, për të gjithë ju anëtarë të KPF-së dhe drejtorët që janë prezent në këtë mbledhje. Mirë se keni ardhur në mbledhjen e shtatë të rregullt të KPF-së. Materialin e keni marrë me kohë. Sot e kem këtë mbledhje të KPF-së me këtë rend të ditës. Kjo informata e prokurimit vjen vetëm në KPF. Nëse ka ndonjë pyetje jasht rendit të ditës hapim debat.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Ka qenë në rregull që, përveç Zyrës së Prokurimit, me kërku edhe prej Zyrës së Auditimit me sjell informatën, dhe edhe çështja e auditimit duhet me ardh vetëm në KPF. Vetëm në raste të veçanta, auditimi e sjell infomatën në Kuvend, përndyshe duhet me pru informatën në KPF edhe Zyra e Auditimit.

z.Illir Zuka: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Prej fortunes që e patëm në Pozharan, unë i kam bërë një dy tri kërkesa. Një pjesë e madhe në Pozharan, kemi çrregullim të ndriçimit. Një pjesë rri 24 orë, dhe një pjesë që janë këput do kablla, janë nëpër tokë. Kam kërku nga drejtori i shërbimeve publike disa here, i kam shkru personalisht, po po ama kaloj një muaj sen nuk u ba, sidomos rruga "Sabit Zuka" ka mbet keq. Edhe një bander është tu maj me një shtyllë. Ata KEDS-i e kanë vnu e kanë lanë ashtu. Duhet me ndërmarr najsen, që me e rregullu. Dhe në rrugën "Demiri" nuk ndalet ndriçimi 24 orë.

z.Jakup Demiri: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Nënkryetari tha me pru raportin e auditimit. Për cilin raport e ke fjalën? Të auditorit të brendshëm.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Raportin e brendshëm të auditimit.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Pasi që nuk ka debat, vazhdojmë me rendin e ditës. Materialin e keni marrë me kohë, për këtë mbledhje kemi këtë

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e gjashtë e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Informatë e prokurimeve dhe kontratave të nënshkruara për vitin fiskal 2026 (Janar-Qershor 2026).

A kanë ndonjë propozim për rendin e ditës. Nëse nuk ka, a jeni që të miratohet rendi i ditës? Nga të gjithë të pranishmit u miratu rendi i ditës.

Si pikë e parë e rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e gjashtë e Komitetit për Politikë dhe Financa

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: A ka me diskutu për këtë pikë?

z.Jakup Demiri: Kishin hi do muhabete që janë diskutu si debat, e e rregullojmë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: A jeni që të miratohet procesverbali me këtë që e tha Jakupi? Nga të gjithë të pranishmit u miratu procesverbali.

Si pikë e dytë e rendit të ditës:

2. Informatë e prokurimeve dhe kontratave të nënshkruara për vitin fiskal 2026 (janar-qershor 2026)

z.Fadil Abazi, shef i Zyrës së Prokurimit: Përshëndetje për të gjithë. Unë e kam përgatitë një informat për prokurimet dhe kontratat e nënshkruara për gjashtëmujorin e parë të vitit 2026. E kam ofru një tabelë, ku janë të cekura kontratat që janë nënshkru. I keni informatat të gjitha në të. Edhe pse po dihen problemet e buxhetit, në krahasim me planin e prokurimit jemi shumë mbrapa, sikur vjet që kemi ngecë në zhvillimin. Nuk kemi pasë mundësi me i zhvillu procedurat. Krejt të njëjtin problem e kemi edhe këtë vit. Deri tash i kemi zhvillu 27 procedura, aktivitete të ndara në: 12 aktivitete shërbime, 3 janë lëndë të prokurimit dhe 12 janë furnizime. Prej këtyre, 14 aktivitete janë përmbyllë, janë nënshkru kontratat, 1 është anulë. Ndërsa, sa i përket metodave të procedurës: 20 janë procedura të hapura, 5 janë kuotim i çmimeve, ndërsa 2 aktivitete janë me vlera minimale. Vlera e përgjithshme e kontratave të nënshkruara është 1 milion e 790 mijë euro. Materialin e keni marrë me kohë. Për pyetjet shtesë jam në dispozicion të juaj.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Këta numrat që janë te lloji i prokurimit këtu; çka tregojnë?

z.Fadil Abazi shef i zyrës së prokurimit: Këto janë procedura, numra të prokurimit. P.sh., nr. 5 tregon që aktiviteti është punë, nr. 2 tregon që aktiviteti është shërbim, nr. 1 tregon që është furnizim. Kështu janë të klasifikuar. Kush e njeh punën e prokurimit e din ma mirë se çka janë këta numra.

z.Illir Zuka: Një pyetje jashtë këtij materiali: tenderat që janë dhënë edhe ka kontrata që janë mbyllë, e punët nuk janë përfundu, p.sh. trotualet në Pozharan, Lagjja Pira, dhe rruga "Demiri e Sabit Zuka".

z.Fadil Abazi shef i zyrës së prokurimit: Nuk ka pare asnjë punë, s'mun e përfundon pa pasë pare. Janë mbyllë kontratat e dikun e kemi vazhdu, e nuk mundesh asnjë operatori ekonomik me i thanë: "Bëje punën", nëse nuk ki zotim. Ma herët e kemi thanë: "Puno se t'i qesim paret", tash kërkush nuk punon pa e pasë zotimin e mjeteve. Tash edhe problemi është që nuk mundemi na me marrë masa ndaj operatorit ekonomik nëse nuk e kemi zotimin e mjeteve. P.sh., e bajmë zotimin, e nxjerrim urdhërblerjen, ia dërgoj operatorit dhe i thamë: "Puno". Nëse nuk i ke këto, ligji thotë se nuk guxon asnjë urdhër me e dhanë me shkrim, as me e-mail me i çu, sepse nuk lejon ligji i prokurimit. Tash e kanë ba një rregullore të re që e kanë ba financat, duhet me u ba komplet zotimi. D.m.th., nuk po muj me ba pare që me ba zotimin e me ju thanë me fillu punën, sepse përmbartuesi nuk po na len pare, po i merr.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Te zotimi e kemi zotu pare për një punë, e pa nisë me punu, vjen përmbartuesi i merr paret e zotume. A duhesh me i thanë punëkryesit: "Mos puno, se janë marrë paret"?

z.Fadil Abazi, shef i Zyrës së Prokurimit: Po kemi edhe kësi probleme që i merr paret e zotume, po na po e kemi problemin që as pare nuk po kemi. Qeveria mundet me na rimbursu, por nuk ka vullnet.

z.Jakup Demiri: Kjo p.sh.: Zyra e Prokurimit ka kryer edhe 50 rekomandime dhe prokurime të ndryshme të punësimeve dhe komisioneve tjera.

z.Fadil Abazi, shef i Zyrës së Prokurimit: D.m.th., që Ligji i Prokurimit jep që komisionet e hapjes dhe vlerësimit, d.m.th., japin vlerësimet rekomanduese. D.m.th., ne rekomandojmë, një komision e aprovon kryetari me nënshkrim. Ai është rekomandim, nuk kam drejtë unë me marrë vendime. Vendimet tjera janë komisionet e pranimeve teknike, menaxherat etj.

z.Jakup Demiri: Ndërsa aktivitetet e zhvilluara në prokurim, disa aktivitete të prokurimit janë anuluar dhe një aktivitet është në procedurë të ankimimit.

z.Fadil Abazi, shef i Zyrës së Prokurimit: Ankimimi është në OSHP. Është kjo e pastrimit të objekteve. Anulimin e kemi bërë të kompjuterave, se na ka dalë oferta mbi çmime. Se, nëse ne planifikojmë 20 mijë euro e oferta vjen 30 mijë euro, dmth. automatikisht ligji e anulon, për shkak që substancialisht e tejkalon buxhetin. Kështu që, ne kemi pasë 25 mijë euro me ble kompjutera, e 40 mijë euro na ka ardhë oferta dhe e kemi anuluar. Tash e kemi përsëritë, me na ardhë brenda planifikimit.

z.Jakup Demiri: Këtu e kemi të faqja e dytë, shërbimet e gjirimit, transmetimit për nevojat e Komunës, diku 40 mijë euro. Kjo është për 6 muaj.

z.Fadil Abazi, shef i Zyrës së Prokurimit: Jo, kjo është për 1 vit, televizioni, është shërbimet e gjirimit, dhe këtë nuk e kemi nënshkruar, se nuk ka parë. Kjo ka shkuar dhe në OSHP, e ka fituar televizioni jo i Komunës sonë, dhe kemi mbetur që, nëse Drejtoria e Financave na siguron buxhet.

z.Jakup Demiri: Kam dhe 1 pyetje jashtë kësaj. P.sh.: janë 3 rrugë që janë shtrur në Smirë, në kohë fushate. Për ato nuk ka pas procedurë.

z.Fadil Abazi, shef i Zyrës së Prokurimit: Me sa po di unë, është kjo kontratë që kemi nënshkruar në 2024, për rrugë rurale.

z.Basri Aliu: Ku është çështja kur po thu, tani që më procedurat e tenderimit pa zotim.

z.Fadil Abazi, shef i Zyrës së Prokurimit: Te aktivitetet e punës.

z.Basri Aliu: Këto procedura që udhëheq niveli qendror, disa tender që i kanë, si p.sh.: e pashë dhe te kompjuterat, po si duket kjo te kompjuterat paska kalu në nivel komunal.

z.Fadil Abazi, shef i Zyrës së Prokurimit: Jo, nivel qendror është, por mini procedurë i thojmë ne. Ata e kanë kontratën. Ne shkojmë blejmë në kontratë të tyre.

z.Basri Aliu: Sa po e shoh, në 6-mujorin e ardhshëm problem qenka me zhvillu ndonjë aktivitet tjetër, pasi e dimë situatën qysh është me buxhet.

zn.Liridona Bislimi: Përsëritet! Pasi që kemi vetëm një pikë të rendit të ditës, dua shkurt me i bërë disa pyetje. Kam përgatit disa pyetje, por mendova që me i dërgu përmes e-mailit zyrtar dhe me i marrë përgjigjet, edhe me i pasë. Dua të di, te ky furnizimi me serra që është anuluar, dua të di arsyen pse është anuluar dhe a e ka planifikimin se kur ka me u thirrë prapë në tenderim.

z.Fadil Abazi, shef i Zyrës së Prokurimit: Përmbaruesi na ka marrë paratë dhe nuk kemi buxhet. Tash edhe subvencionet na i kanë marrë, nuk kemi mjete. Për këtë vit nuk besoj që ka me pasë serra, veç nëse ndryshon ndonjë gjë nga ministria, na i kompensojnë këto që na i ka marrë përmbaruesi.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Pasi që nuk ka për debat, kjo pikë nuk del në votim, pasi që është veç informatë. Me kaq e shpall të mbyllur këtë mbledhje. Ju falënderoj për kontributin e dhënë. Shihemi herave tjera.

Mbledhja përfundoi në ora 10:30

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Bekim Azizi



Republika e Kosovës

Komuna e Vitisë

Bazuar në nenin 58 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare nr 28/2008), dhe nenit 50 shkronja I) të Statutit të Komunës së Vitisë me numër 013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë paraqet këtë :

PROPOZIM VENDIM PËR PROJEKT BUXHETIN E KOMUNËS SË VITISË 2027-2029

Neni 1

Kryetari i Komunës së Vitisë i propozon Kuvendit Komunal që të aprovoj Vendimin „PROJEKT BUXHETI I KOMUNËS SË VITISË 2027-2029“

Duke u bazuar në QARKOREN BUXHETORE 2027/02 të datës 14.08.2026 të lëshuar nga MFPT-ja me nr 987-2/2026 ku paraqet bazën për hartimin e buxhetit për vitin 2027-2029.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij propozim vendimi është „PROJEKT BUXHETIN E KOMUNËS SË VITISË 2027-2029“ e hartuar nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim . Buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2027 është në shumë prej 18,388,643 €, buxheti për vitin 2028 është në shume prej 18,319,667 €, buxheti për vitin 2029 është në shumë prej 19,292,038 €.

Neni 3

Burimet e buxhetit janë: të hyrat nga grandit qeveritar dhe nga të hyrat vetanake komunale.

Të hyrat buxhetore dhe shpenzimet e komunës së Vitisë për vitin 2027 janë: 18,388,643 €

a) Të hyrat nga Grandi Qeveritar 17,054,305 €

b) Të hyrat vetanake komunale 1,334,338 €

Të hyrat buxhetore dhe shpenzimet e komunës së Vitisë për vitin 2028 janë: 18,319,667 €

c) Të hyrat nga Grandi Qeveritar 16,947,181 €

d) Të hyrat vetanake komunale 1,372,486 €

Të hyrat buxhetore dhe shpenzimet e komunës së Vitisë për vitin 2029 janë: 19,292,038 €

e) Të hyrat nga Grandi Qeveritar 17,899,891 €

f) Të hyrat vetanake komunale 1,432,146 €

Buxheti për vitin 2027 shpërndahet në këto kategori ekonomike :

Paga e mëditje	11,480,849. €
Mallra e shërbime	3,013,919. €
Shpenzime komunale	290,000. €
Subvencione dhe transfere	720,000 €
<u>Shpenzime kapitale</u>	<u>2,883,875 €</u>
<u>Totali i buxhetit</u>	<u>18,388,643 €</u>

Neni 4

Për zbatimin e këtij propozim vendimi do të kujdeset Kryetari dhe Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Vitisë.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë dhe e nënshkrimit nga ana e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Vitisë.

PROPOZUES : KRYETARI I KOMUNËS
Sokol Haliti





REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

Pranuar - Prilajeno Me Data 31-08-2026			
Nr. i Organi Org. Breg	Nr. i Organi Org. Breg	Vlera Vrednost	Vlera Vrednost
02-	035/02-	870	



KOMUNA E VITISË

PLAN BUXHETI 2027-2029

Drejtori i drejtoris për FEZH

Milihate Ajeti

Shtator 2026

Kryetari i Komunës

Sokol Haliti



PLAN BUXHETI 2027-2029

Buxheti është instrumenti më i rëndësishëm i politikës ekonomike që ka në dispozicion qeveria komunale, dhe si i tillë ai pasqyron prioritetet e saja zhvillimore. Derisa buxheti rregullon të hyrat dhe shpenzimet për një vit fiskal të caktuar, procesi buxhetor është i vazhdueshëm dhe përsëritet çdo vit.

Komuna në muajin qershor ka hartuar Kornizën Afatmesme Buxhetore të shpenzimeve (KAB-i), një dokument planifikues afatmesëm që synon të përmirësojë parashikueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e buxhetit, duke përfshirë buxhetin e vitit të ardhshëm fiskal dhe parashikimet buxhetore edhe për dy vitet fiskale të tjera, kur hartohet buxheti vjetor, Ministria e Financave e Punës dhe Transfereve ka nxjerr qarkoret buxhetore 1 dhe 2 që japin kufijt fillestar dhe final, informata dhe udhëzime rreth strukture së shpenzimeve në fonde burimore dhe kategori ekonomike për vitin e ardhshëm fiskal dhe parashikimet për dy vitet pasuese, përcaktojnë procesin e bashkërendimit midis organizatave buxhetore dhe Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve.

Përgatitja e buxhetit 2027 - 2029 ka filluar nga muaji maj i vitit 2026, konform LMFPP dhe Ligjit të Financave të Pushtetit Lokal. Këtë periudhë kohore e kanë përcjell dy qarkore buxhetore të lëshuara nga MFPT-ja, qarkorja e parë buxhetore 2027/01 të datës 15.05.2026 dhe qarkoren e dytë të datës 14.08.2026.

Me qarkoren buxhetore 2027/01 jemi njoftuar për kufijt fillestar të shpenzimeve të granteve buxhetore për vitin 2027 si dhe parashikimet për vitin 2028 dhe 2029 si dhe me qarkoren e dytë 2027/02 janë përcaktuar kufijt final të kategorive ekonomike.

Plan buxheti i vitit 2027 është përgatitur në bazë të Statutit të Komunës së Vitisë, duke bërë shpërndarjen e fondeve nëpër drejtori / programe dhe nënprograme.

Në qarkoren e dytë buxhetore 2027/02 janë dhënë kufijt final të shpenzimeve sipas kategorive ekonomike (duke përfshirë shpenzimet e pagave dhe shtesave, mallëra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe transfere dhe investime kapitale) për vitet 2027-2029.

Buxheti komunal për vitin fiskal 2026-2029 do të paraqitet sipas 5 kategorive ekonomike për shpenzimet e buxhetuara në pajtim me rregullat e thesarit:

1. Paga e shtesa,
2. Mallëra dhe shërbime,
3. Shpenzime komunale

KUFIJT BUXHETOR SIPAS KATEGORIVE EKONOMIKE PËR VITET 2026-2029					
nr.	Kategorit ekonomike	2026	2027	2028	2029
1	Paga e mëditje	10,870,225	11,480,849	11,538,254	11,595,945
2	Mallra e shërbime	3,078,919	3,013,919	3,013,919	3,013,919
3	Shpenzime komunale	290,000	290,000	290,000	290,000
4	Subven. e transfere	720,000	720,000	720,000	720,000
5	Shpenzime kapitale	3,365,071	2,883,875	2,757,494	3,672,174
	Totali	18,324,215	18,388,643	18,319,667	19,292,038

Dallimi i buxhetit në mes të viteve 2026 dhe 2027

nr.	Kategorit ekonomike	2026	2027	Diferenca/ ndryshimi	%
1	Paga e mëditje	10,870,225	11,480,849	610,624	5.62
2	Mallra e shërbime	3,078,919	3,013,919	(65,000)	(2.11)
3	Shpenzime komunale	290,000	290,000	-	-
4	Subven. e transfere	720,000	720,000	-	-
5	Shpenzime kapitale	3,365,071	2,883,875	(481,196)	(14.30)
	Totali	18,324,215	18,388,643	64,428	0.35

Buxheti i Komunës së Vitisë përbëhet nga dy burime kryesore.

1. **Grantet qeveritare** (granti i përgjithshëm, granti specifik i arsimit dhe granti specifik i shëndetësis dhe granti për shërbime rezidenciale),
2. **Të hyrat vetanake komunale.**

Buxheti i Komunës së Vitisë si tërësi ka shënuar rritje në vitin 2027 në krahasim me vitin 2026 në vlerë prej 64,428 € ose prej 0.35 %.

Rritje është reflektuar në grantin e përgjithshëm prej 1,193,234, zvoglim në grantin specifik të arsimit në vlerë prej -1,269,785 €, rritje në grantin specifik të shëndetësis 101,301 €, total grantet qeveritare kanë rritje prej 24,750 €.

Të hyrat vetanake komunale kanë shënuar rritje në shumë prej 39,678 €.

Duke u bazuar në qarkoren buxhetore 2027/02 buxheti i shpërndarë nëpër kategori ekonomike për vitin 2027:

1. Kategoria ekonomike e pagave dhe shtesave

Kemi rritje të kategoris ekonomike të pagave dhe shtesave në vlerë prej 610,624 €.

Kategorinë ekonomike të pagave e mëditjeve e ndarë në katër linja buxhetore :

Programet	Shuma në €	%
Administrata	1,968,348.00	17.14
Arsim e shkencë	7,752,712.00	67.53
Shëndetsi dhe mirëqenje sociale	1,621,622.00	14.12
Shërbimet sociale-rezidenciale	138,167.00	1.20
Totali	11,480,849	100.00

2. Kategoria ekonomike mallëra dhe shërbime

Duke u bazuar në qarkoren buxhetore 2027/02 është bërë zbritja e kategorisë ekonomike të mallërave e shërbimeve nga viti 2026 në shumë prej -65,000.00 € e shpërndarë në këto linja buxhetore:

Programet	Shuma në €	%
Administrata	1,686,684.00	55.96
Arsim e shkencë	430,000.00	14.27
Shëndetsi dhe mirëqenje sociale	847,235.00	28.11
Shërbimet sociale dhe rezidenciale	50,000.00	1.66
Totali	3,013,919.00	100.00

- Grantet qeveritare kan marrë pjesë në mallëra e shërbime në shumë prej 2.749,828 €
- Të hyrat vetanake kan marrë pjesë në mallëra e shërbime në shumë prej 379,091 €.

3. Kategoria ekonomike shpenzime komunale

Shuma e mjeteve në kategorinë ekonomike të shpenzimeve komunale është e njëjt me vitin 2026 , dhe tërësisht është e financuar nga granti qeveritar me një total prej 290,000 € në këto linja buxhetore.

Programet	Shuma në €	
Administrata	137200	47.31
Arsim e shkencë	95000	32.76
Shërbimet sociale dhe rezidenciale	5000	1.72
Shëndetsi dhe mirëqenje sociale	52800	18.21
Totali	290,000	100.00

4. Kategoria ekonomike subvencione dhe transfere

Kategoria e subvencioneve dhe transfere në vitin 2027 janë në vlerë të njëjt si në vitin 2025 prej 720,000 € e shpërndarë në këto programe:

Programet	shuma në €	në %
Zyra e kryetarit	170,000	23.61
Kulturë, Rini e Sport	150,000	20.83
Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	350,000	48.61
Shërbimet sociale	50,000	6.95
Totali	720,000	100.00

5. Kategoria ekonomike e investimeve kapitale

Te kategoria e investimeve kapitale në vitin 2026 ishin në vlerë prej 3,365,071 €, kemi zbritje të buxhetit në vitin 2027 prej 481,196 €.

Në vitin 2026 investimet kapitale janë në shumë prej 2,883,875 €.

Investimet kapitale nga grantet e qeveris

2,088,628.00 €

Investimet kapitale nga të hyrat vetanake

795,247.00 €

Shuma e investimeve kapitale e shpërndarë në këto programe:

Programet	Shuma në €	%
Administrata	2,633,875	91.33
Arsim e shkencë	140,000	4.85
Shëndetsi dhe mirëqenje sociale	60,000	2.08
Shërbimet sociale-rezidenciale	50,000	1.73
Totali	2,883,875	100.00

Shpërndarja e buxhetit për vitin 2027 është si vijon :

1. Administrata

7,096,107 €

2. Arsimi

8,417,712 €

3. Shëndetësia dhe mirëqenja sociale

2,581,657 €

4. Shërbimet sociale

293,167 €

Totali

18,388,643

SHPËRNDARJA E BUXHETIT SIPAS LINJAVE DHE GRANTEVE PËR VITIN 2027

Shpenzimet e linjave buxhetore	Paga & shitesa	Mallra e shërbime	Komunal	Subvencione dhe transfere	Investime kapitale	Totali	Nr. max i
160 Administrata komunale	1,968,348	1,686,684	137,200	670,000	2,633,875	7,096,107	200
920 Arsime	7,752,712	430,000	95,000	-	140,000	8,417,712	824
730 Shëndetësi dhe mirëqenia sociale	1,621,622	847,235	52,800	-	60,000	2,581,657	149
755 Shërbimet sociale- rezidenciale	138,167	50,000	5,000	50,000	50,000	293,167	15
TOTALI	11,480,849	3,013,919	290,000	720,000	2,883,875	18,388,643	1188

Shpenzimet e granteve buxhetore	Paga & shitesa	Mallra e shërbime	Komunal	Subvencione dhe transfere	Investime kapitale	Totali
10 Granti i përgjithshëm	4,361,978	1,911,063	237,200	500,000	2,043,058	9,053,299
10 Granti i Arsimit	5,540,526	344,077	-	-	45,570	5,930,173
10 Granti i Shëndetësis	1,578,345	439,688	52,800	-	-	2,070,833
21 Të hyrat vetanake	-	319,091	-	220,000	795,247	1,334,338
TOTALI	11,480,849	3,013,919	290,000	720,000	2,883,875	18,388,643

SHËRNDARJA E BUXHETIT SIPAS LINJAVE DHE GRANTEVE BUXHETORE

Tabela e plan buxhetit për vitin 2027

Kodi	Viti	Nr i puntorëve	Totali i granteve	Granti i përgjithshëm	Granti i arsimit	Granti i shëndetësisë	Të hyrat vetanake
657	Programet	1188	18,388,643	9,053,299	5,930,173	2,070,833	1,334,338
	Administrata	200	7,096,107	5,991,769	-	-	1,104,338
111	Paga dhe shtesa		1,968,348	1,968,348			
130	Mallra e Shërbime		1,686,684	1,507,593			
132	Shpenzime Komunale		137,200	137,200			179,091
200	Subvencione dhe transfere		670,000	470,000			
300	Shpenzime kapitale		2,633,875	1,908,628			200,000
	Arsimi	824	8,417,712	2,437,539	5,930,173	-	725,247
111	Paga dhe shtesa		7,752,712	2,212,186	5,540,526		50,000
130	Mallra e Shërbime		430,000	45,923	344,077		
132	Shpenzime Komunale		95,000	95,000			40,000
200	Subvencione dhe transfere		-				
300	Shpenzime kapitale		140,000	84,430	45,570		
	Shëndetësia	149	2,581,657	350,824	-	2,070,833	10,000
111	Paga dhe shtesa		1,621,622	43,277			160,000
130	Mallra e Shërbime		847,235	307,547		1,578,345	
132	Shpenzime Komunale		52,800			439,688	100,000
200	Subvencione dhe transfere		-			52,800	
300	Shpenzime kapitale		60,000				
	Shërbimet sociale	15	293,167	273,167	-	-	60,000
111	Paga dhe shtesa		138,167	138,167			20,000
130	Mallra e Shërbime		50,000	50,000			
132	Shpenzime Komunale		5,000	5,000			
200	Subvencione dhe transfere		50,000	30,000			
300	Shpenzime kapitale		50,000	50,000			20,000

Tabela përmbledhëse

Kategorit ekonomike	Granti i përgjithshëm dhe grantet specifike	E hyra vetanake	Shuma në €
Paga dhe shtesa	11,480,849	0	11,480,849
Mallra e shërbime	2,694,828	319,091	3,013,919
Shpenzime komunale	290,000	0	290,000
Subvencione dhe transfere	500,000	220,000	720,000
Shpenzime kapitale	2,088,628	795,247	2,883,875
TOTALI	17,054,305	1,334,338	18,388,643

Forma finale e plan buxhett për vitin 2027

Forma finale e plan buxhetit për vitin 2027												
Shpenzimet							Burimet e financimit					
Drejtoritë	Nr pun	Paga & shitesa	Mallra dhe shërbime	Shpenzimet Komunale	Subvencione dhe transferet	Shpenzime kapitale	Totali	Granti i përgjithshëm	Granti specifik i arsimit	Granti specifik i shëndetësisë	HYK	Totali
Totali i Ad	199	1,968,348.00	1,686,684.00	137,200.00	670,000.00	2,633,875.00	7,096,107.00	5,991,769.00	0.00	0.00	1,104,338.00	7,096,107.00
Zyra e kryetar	38	430,000	110,000		170,000.00		710,000.00	620,000.00			90,000.00	710,000.00
Zyra e kuvert	27	282,000	12,000				294,000.00	292,000.00			2,000.00	294,000.00
Administratë e	33	263,950	64,000				327,950.00	327,950.00				327,950.00
Buxhët e Financ	25	231,730	60,000			2,633,875.00	2,925,605.00	2,190,358.00				2,925,605.00
Inspektoriat	8	90,484	70,000				160,484.00	160,484.00				160,484.00
Shërbu publik	34	350,404	1,314,684	137,200.00			1,802,288.00	1,675,197.00				1,802,288.00
Bujtësi Pylltar	6	57,285	5,000		350,000.00		412,285.00	312,285.00			100,000.00	412,285.00
Kadaster, G	8	72,893	5,000				77,893.00	77,893.00				77,893.00
Urbanizëm, P	5	56,255	5,000				61,255.00	61,255.00				61,255.00
Kulturë Rinor	12	104,427	40,000		150,000.00		294,427.00	244,427.00				294,427.00
Zik	3	28,920	1,000				29,920.00	29,920.00				29,920.00
Totali i Ar	824	775,271.2	430,000	95,000	0	140,000	841,771.2	243,753.9	59,301.73	0	50,000	841,771.2
Drejtoritë e A	9	88,227.00	10,000.00				193,227.00	183,227.00				193,227.00
Gjini ynë -q	41	311,422.00	50,000.00				361,422.00	1,650,000.00	4,307,600.00			1,957,600.00
Arsinimi filior	604	5,687,600.00	270,000.00				5,957,600.00	600,000.00	1,295,463.00			5,957,600.00
Arsinimi i mes	170	1,665,463.00	100,000.00				1,905,463.00	600,000.00	1,295,463.00			1,905,463.00
Totali i Sh	149	1,621,622.00	847,235.00	52,800.00	0.00	140,000.00	2,581,657.00	350,824.00	0.00	2,070,833.00	160,000.00	2,581,657.00
Administrata e	3	29,361	2,000				31,361.00	31,361.00				31,361.00
Shërbimet e k	146	1,592,261	845,235	52,800.00			2,550,296.00	319,463.00				2,550,296.00
Shërbimet	15	138,167	50,000.00	5,000.00	50,000.00	60,000.00	293,167.00	273,167.00	0.00	2,070,833.00	180,000.00	2,93,167.00
Shërbimet sot	15	138,167	50,000	5,000.00	50,000.00	50,000.00	293,167.00	273,167.00			20,000.00	293,167.00
TOTALI	1187	11,480,849.00	3,013,919.00	290,000.00	720,000.00	2,883,875.00	18,388,643.00	9,053,299.00	5,930,173.00	2,070,833.00	1,334,338.00	18,388,643.00


PLAN BUXHETI PËR TË GJITHA PROGRAMET BUXHETORE PËR VITIN 2027

Paraqitja totale e buxhetit për vitin 2027


Shpenzimet e linjave buxhetore		Totali	%
160	Administrata komunale	7,096,107.00	38.59
920	Arsimi	8,417,712.00	45.78
730	Shëndetësia	2,581,657.00	14.04
755	Shërbimet sociale	293,167.00	1.59
Shpenzimet e linjave buxhetore		18,388,643.00	100.00

Burimet e financimit			%
10	Granti i përgjithshëm	9,053,299.00	49.23
10	Granti specifik i Arsimit	5,930,173.00	32.25
10	Granti specifik i Shëndetësisë	2,070,833.00	11.26
21	Të hyrat vetanake	1,334,338.00	7.26
TOTALI		18,388,643.00	100.00

Paraqitja grafike e total buxhetit për vitin 2024



Paraqitja grafike e total buxhetit sipas burimit të financimit




Paraqitja e pagave dhe shtesave për të gjitha programet për vitin 2027


Shpenzimet e linjave buxhetore		Totali i pagave	%
160	Administrata komunale	1,968,348.00	17.14
920	Arsimi	7,752,712.00	67.53
730	Shëndetësia	1,621,622.00	14.12
755	Shërbimet sociale	138,167.00	1.20
Shpenzimet e linjave buxhetore		11,480,849.00	100.00

Burimet e financimit			
10	Granti i përgjithshëm	4,361,978.00	37.99
10	Granti specifik i Arsimit	5,540,526.00	48.26
10	Granti specifik i Shëndetësisë	1,578,345.00	13.75
21	Të hyrat vetanake		0.00
TOTALI		11,480,849.00	100.00

Paraqitja grafike per paga dhe shtesave per te gjitha linjat buxhetore



Paraqitja grafike per paga dhe shtesave sipas burimeve te financimit




Paraqitja e mallrave dhe shërbimeve për të gjitha programet për vitin 2027


Shpenzimet e linjave buxhetore		Totali i mallrave dhe Shërbimeve	%
160	Administrata komunale	1,686,684.00	55.96
920	Arsimi	430,000.00	14.27
730	Shëndetësia	847,235.00	28.11
755	Shërbimet sociale	50,000.00	1.66
Shpenzimet e linjave buxhetore		3,013,919.00	100.00

Burimet e financimit			%
10	Granti i përgjithshëm	1,911,063.00	63.41
10	Granti specifik i Arsimit	344,077.00	11.42
10	Granti i Shëndetësisë	439,688.00	14.59
21	Të hyrat vetanake	319,091.00	10.59
TOTALI		3,013,919.00	100.00

Paraqitja grafike për mallra dhe shërbime për të gjitha linjat buxhetore



Paraqitja Grafike për mallra dhe shërbime sipas burimeve të financimit




Paraqitja e shpenzimeve komunale për të gjitha programet për vitin 2027


Shpenzimet e linjave buxhetore		Totali i Shpenzimeve komunale	%
160	Administrata komunale	137,200.00	47.31
920	Arsimi	95,000.00	32.76
730	Shëndetësia + shërb soociale	57,800.00	19.93
Shpenzimet e linjave buxhetore		290,000.00	100.00

Burimet e financimit			%
10	Granti i përgjithshëm	232,200.00	80.07
10	Granti specifik i Arsimit	0.00	0.00
10	Granti specifik i Shëndetësis	52,800.00	18.21
10	Granti i shërb sooc rezidenciale	5,000.00	1.69
21	Të hyrat vetanake		0.00
TOTALI		290,000.00	99.97

Paraqitja grafike e shpenzimeve komunale sipas linjave buxhetore



Paraqitja grafike e shpenzimeve komunale sipas burimeve te financimit




Paraqitja e subvencioneve dhe transfereve për të gjitha programet për vitin 2027


Shpenzimet e linjave buxhetore		Totali i Subvencioneve dhe transfereve	%
160	Administrata komunale	670,000.00	93.06
920	Arsimi	0.00	0.00
730	Shëndetsia	0.00	0.00
755	Shërbimet sociale	50,000.00	6.94
Shpenzimet e linjave buxhetore		720,000.00	100.00

Burimet e financimit		Totali i Subvencioneve dhe transfereve	%
10	Granti i përgjithshëm	500,000.00	69.44
10	Granti specifik i Arsimit	0.00	0.00
10	Granti specifik i Shëndetësisë	0.00	0.00
21	Të hyrat vetanake	220,000.00	30.56
TOTALI		720,000.00	100.00

Paraqitja Grafike e subvencioneve dhe transfereve sipas linjave buxhetore



Paraqitja grafike e subvencioneve dhe tranferave sipas burimit të financimit




Paraqitja e investimeve kapitale për të gjitha programet për vitin 2027


Shpenzimet e linjave buxhetore		Total i shpenzimeve kapitale	%
160	Administrata komunale	2,633,875.00	91.33
920	Arsimi	140,000.00	4.85
730	Shëndetësia	60,000.00	2.08
755	Shërbime rezidenciale	50,000.00	1.73
Shpenzimet e linjave buxhetore		2,883,875.00	100.00

Burimet e financimit			%
10	Granti i përgjithshëm	2,043,058.00	70.84
10	Granti specifik i Arsimit	45,570.00	1.58
10	Granti specifik i Shëndetësisë	0.00	0.00
21	Të hyrat vetanake	795,247.00	27.58
TOTALI		2,883,875.00	100.00

Paraqitje grafike ne kategorin e investimeve kapitale për të gjitha linjat buxhetore



Paraqitja grafike ne kategorin e Investimeve kapitale sipas burimeve te financimit




PLAN BUXHETI PËR TË GJITHA PROGRAMET BUXHETORE PËR VITIN 2027

Paraqitja sipas kategorive ekonomike


657 Kategorit ekonomike		Shuma	%
111	Pagat dhe shtesat	11,480,849	62.43
130	Mallrat dhe shërbime	3,013,919	16.39
132	Shpenzime komunale	290,000	1.58
200	Subvencione, transfere	720,000	3.92
300	Shpenzimet kapitale	2,883,875	15.68
TOTALI		18,388,643	100.00

Paraqitja Grafike sipas kategorive ekonomike



Buxheti Komunal nëpër vite

Viti 2026	
Viti 2027	18,324,215.00
Viti 2028	18,388,643.00
Viti 2029	18,319,667.00
	19,292,037.00



0 Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2027

Nr.	Përshkrimi	Stafi	Pagat dhe shtesa	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Total
a	d	e	f	g	h	i	j	k
1	SHPENZIMET TOTALE KOMUNALE	1188	11,480,849	3,013,919	290,000	720,000		18,388,643
	Grantet Qeveritare	1188	11480849	2694828	290000	500000	2088628	17054305
	Të hyrat vetanake	0	0	319091	0	220000	795247	1334338
1	Zyra e Kryetarit	38	430000	110000	0	170000	0	710000
	Grantet Qeveritare	38	430000	70000	0	120000		620000
	Të hyrat vetanake		0	40000		50000		90000
2	Zyra e Kuvendit Komunal	27	282000	12000	0	0	0	294000
	Grantet Qeveritare	27	282000	10000				292000
	Të hyrat vetanake			2000				2000
3	Administrata	33	263950	64000	0	0	0	327950
	Grantet Qeveritare	33	263950	64000	0		0	327950
	Të hyrat vetanake	0	0	0	0	0	0	0
3.1	Administrata	31	246000	50000	0	0	0	296000
	Grantet Qeveritare	31	246000	50000				296000
	Të hyrat vetanake							0
3.2	Komunikimi	2	17950	14000	0	0	0	31950
	Grantet Qeveritare	2	17950	14000				31950
	Të hyrat vetanake							0
4	Inspektimet	8	90484	70000	0	0	0	160484
	Grantet Qeveritare	8	90484	70000				160484
	Të hyrat vetanake							0
5	Financa,Ekonomi dhe Zhvillim	25	231730	60000	0	0	2633875	2925605
	Grantet Qeveritare	25	231730	50000			1908628	2190358
	Të hyrat vetanake			10000			725247	735247
6	Shërbimet publike, mbrojtja civile, emergjencia	34	350404	1314684	137200	0	0	1802288
	Grantet Qeveritare	34	350404	1187593	137200	0	0	1675197
	Të hyrat vetanake		0	127091	0	0	0	127091
6.1	Infrastruktura publike	7	64874	1294684	132200	0	0	1491758
	Grantet Qeveritare	7	64874	1167593	132200			1364667
	Të hyrat vetanake			127091				127091
6.2	Zjarrfikësit dhe inspektimet	27	285530	20000	5000	0	0	310530
	Grantet Qeveritare	27	285530	20000	5000			310530
	Të hyrat vetanake							0
7	ZKK	3	28920	1000	0	0	0	29920
	Grantet Qeveritare	3	28920	1000				29920
	Të hyrat vetanake							0
8	Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural	6	57285	5000	0	350000	0	412285
	Grantet Qeveritare	6	57285	5000		250000		312285
	Të hyrat vetanake					100000		100000
9	Kadastra dhe gjeodezia	8	72893	5000	0	0	0	77893
	Grantet Qeveritare	8	72893	5000				77893
	Të hyrat vetanake							0
10	Planifikimi urban	5	56255	5000	0	0	0	61255
	Grantet Qeveritare	5	56255	5000				61255
	Të hyrat vetanake							0
11	Shëndetësia dhe mirëqenia sociale	149	1621622	847235	52800	0	60000	2581657

	Grantet Qeveritare	149	1621622	747235	52800	0	0	2421657
	Të hyrat vetanake		0	100000	0	0	60000	160000
11.1	Administrata	3	29361	2000	0	0	0	31361
	Grantet Qeveritare	3	29361	2000				31361
	Të hyrat vetanake							0
11.2	Shërbimet e shëndetësisë pr	146	1592261	845235	52800	0	60000	2550296
	Grantet Qeveritare	146	1592261	745235	52800			2390296
	Të hyrat vetanake			100000			60000	160000
12	Shërbimet sociale	16	138167	50000	5000	50000	50000	293167
	Grantet Qeveritare	16	138167	50000	5000	30000	50000	273167
	Të hyrat vetanake					20000		20000
13	Shërbimet kulturore	12	104427	40000	0	150000	0	294427
	Grantet Qeveritare	12	104427	40000		100000		244427
	Të hyrat vetanake					50000		50000
14	Arsimi	824	7752712	430000	95000	0	140000	8417712
	Grantet Qeveritare	824	7752712	390000	95000	0	130000	8367712
	Të hyrat vetanake		0	40000	0	0	10000	50000
14	Administrata	9	88227	10000	95000	0	0	193227
	Grantet Qeveritare	9	88227	0	95000			183227
	Të hyrat vetanake			10000				10000
14	Arsimi parashkollor dhe qer	41	311422	50000	0	0	0	361422
	Grantet Qeveritare	41	311422	20000				331422
	Të hyrat vetanake			30000				30000
14	Arsimi fillor	604	5687600	270000	0	0	0	5957600
	Grantet Qeveritare	604	5687600	270000				5957600
	Të hyrat vetanake							0
14	Arsimi I mesëm	170	1665463	100000	0	0	140000	1905463
	Grantet Qeveritare	170	1665463	100000			130000	1895463
	Të hyrat vetanake						10000	10000

0 Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2028

Nr	Përshkrimi	Stafi	Pagat dhe shtesa	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Total
a	d	e	f	g	h	i	j	k
1	SHPENZIMET TOTALE KOMUNALE	1188	11,538,254	3,013,919	290,000	720,000	2,757,494	18,319,667
	Grantet Qeveritare	1188	11538254	2694828	290000	500000	1924099	16947181
	Të hyrat vetanake	0	0	319091	0	220000	833395	1372486
1	Zyra e Kryetarit	38	432000	110000	0	170000	0	712000
	Grantet Qeveritare	38	432000	70000	0	120000	0	622000
	Të hyrat vetanake		0	40000		50000		90000
2	Zyra e Kuvendit Komunal	27	283000	12000	0	0	0	295000
	Grantet Qeveritare	27	283000	10000				293000
	Të hyrat vetanake			2000				2000
3	Administrata	34	265000	64000	0	0	0	329000
	Grantet Qeveritare	34	265000	64000	0		0	329000
	Të hyrat vetanake	0	0	0	0	0	0	0
3	Administrata	32	247000	50000	0	0	0	297000
	Grantet Qeveritare	32	247000	50000				297000
	Të hyrat vetanake							0
3	Komunikimi	2	18000	14000	0	0	0	32000
	Grantet Qeveritare	2	18000	14000				32000
	Të hyrat vetanake							0
4	Inspektimet	8	91000	70000	0	0	0	161000
	Grantet Qeveritare	8	91000	70000				161000
	Të hyrat vetanake							0
5	Financa,Ekonomi dhe Zhvillim	25	232730	60000	0	0	2507494	2800224
	Grantet Qeveritare	25	232730	50000			1744099	2026829
	Të hyrat vetanake			10000			763395	773395
6	Shërbimet publike, mbrojtja civile, emergjenca	34	351730	1314684	137200	0	0	1803614
	Grantet Qeveritare	34	351730	1187593	137200	0	0	1676523
	Të hyrat vetanake		0	127091	0	0	0	127091
6	Infrastruktura publike	7	65200	1294684	132200	0	0	1492084
	Grantet Qeveritare	7	65200	1167593	132200			1364993
	Të hyrat vetanake			127091				127091
6	Zjarrfikësit dhe inspektimet	27	286530	20000	5000	0	0	311530
	Grantet Qeveritare	27	286530	20000	5000			311530
	Të hyrat vetanake							0
7	ZKK	3	29000	1000	0	0	0	30000
	Grantet Qeveritare	3	29000	1000				30000
	Të hyrat vetanake							0
8	Bujqësi, pylltari dhe zhvill rur	6	58000	5000	0	350000	0	413000
	Grantet Qeveritare	6	58000	5000		250000		313000
	Të hyrat vetanake					100000		100000
9	Kadastra dhe gjeodezia	8	73200	5000	0	0	0	78200
	Grantet Qeveritare	8	73200	5000				78200
	Të hyrat vetanake							0
#	Planifikimi urban	5	56855	5000	0	0	0	61855
	Grantet Qeveritare	5	56855	5000				61855
	Të hyrat vetanake							0
#	Shëndetësia dhe mirëqenia sociale	149	1632122	847235	52800	0	60000	2592157

	Grantet Qeveritare	149	1632122	747235	52800	0	0	2432157
	Të hyrat vetanake		0	100000	0	0	0	160000
11.	Administrata	3	29861	2000	0	0	60000	31861
	Grantet Qeveritare	3	29861	2000			0	31861
	Të hyrat vetanake							0
11.	Shërbimet e shëndetësisë primare	146	1602261	845235	52800	0	60000	2560296
	Grantet Qeveritare	146	1602261	745235	52800			2400296
	Të hyrat vetanake			100000			60000	160000
12	Shërbimet sociale	15	138167	50000	5000	50000	50000	293167
	Grantet Qeveritare	15	138167	50000	5000	30000	50000	273167
	Të hyrat vetanake					20000		20000
#	Shërbimet kulturore	12	105427	40000	0	150000	0	295427
	Grantet Qeveritare	12	105427	40000		100000		245427
	Të hyrat vetanake					50000		50000
#	Arsimi	824	7790023	430000	95000	0	140000	8455023
	Grantet Qeveritare	824	7790023	390000	95000	0	130000	8405023
	Të hyrat vetanake		0	40000	0	0	10000	50000
14	Administrata	9	88927	10000	95000	0	0	193927
	Grantet Qeveritare	9	88927	0	95000			183927
	Të hyrat vetanake			10000				10000
14	Arsimi parashkollor dhe qerdhet	41	315422	50000	0	0	0	365422
	Grantet Qeveritare	41	315422	20000				335422
	Të hyrat vetanake			30000				30000
14	Arsimi fillor	604	5707600	270000	0	0	0	5977600
	Grantet Qeveritare	604	5707600	270000				5977600
	Të hyrat vetanake							0
14	Arsimi i mesëm	170	1678074	100000	0	0	140000	1918074
	Grantet Qeveritare	170	1678074	100000			130000	1908074
	Të hyrat vetanake						10000	10000

0 Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2029

Nr.	Përshkrimi	Stafi	Pagat dhe shtesa	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Total
a	d	e	f	g	h	i	j	k
1	SHPENZIMET TOTALE KOMUNALE	1188	11,595,944	3,013,919	290,000	720,000	3,672,174	19,292,037
	Grantet Qeveritare	1188	11595944	2694828	290000	500000	2779119	17859891
	Të hyrat vetanake	0	0	319091	0	220000	893055	1432146
1	Zyra e Kryetarit	38	432500	110000	0	170000	0	712500
	Grantet Qeveritare	38	432500	70000		120000		622500
	Të hyrat vetanake		0	40000		50000		90000
2	Zyra e Kuvendit Komunal	27	288000	12000	0	0	0	300000
	Grantet Qeveritare	27	288000	10000				298000
	Të hyrat vetanake			2000				2000
3	Administrata	34	265700	64000	0	0	0	329700
	Grantet Qeveritare	34	265700	64000	0			329700
	Të hyrat vetanake	0	0	0	0	0	0	0
3.1	Administrata	32	247500	50000	0	0	0	297500
	Grantet Qeveritare	32	247500	50000	0	0	0	297500
	Të hyrat vetanake							
3.2	Komunikimi	2	18200	14000	0	0	0	32200
	Grantet Qeveritare	2	18200	14000				32200
	Të hyrat vetanake							
4	Inspektimet	8	91300	70000	0	0	0	161300
	Grantet Qeveritare	8	91300	70000				161300
	Të hyrat vetanake							
5	Financa,Ekonomi dhe Zhvillim	25	233730	60000	0	0	3422174	3715904
	Grantet Qeveritare	25	233730	50000			2579119	2862849
	Të hyrat vetanake			10000			843055	853055
6	Shërbimet publike, mbrojtja civile, emergjenca	34	353130	1314684	137200	0	0	1805014
	Grantet Qeveritare	34	353130	1187593	137200	0	0	1677923
	Të hyrat vetanake		0	127091	0	0	0	127091
6.1	Infrastruktura publike	7	65600	1294684	132200	0	0	1492484
	Grantet Qeveritare	7	65600	1167593	132200			1365393
	Të hyrat vetanake			127091				127091
6.2	Zjarrfikësit dhe inspektimet	27	287530	20000	5000	0	0	312530
	Grantet Qeveritare	27	287530	20000	5000			312530
	Të hyrat vetanake							
7	ZKK	3	29100	1000	0	0	0	30100
	Grantet Qeveritare	3	29100	1000				30100
	Të hyrat vetanake							
8	Bujqësi, pylltari dhe zhvill rur	6	58200	5000	0	350000	0	413200
	Grantet Qeveritare	6	58200	5000		250000		313200
	Të hyrat vetanake					100000		100000
9	Kadastra dhe gjeodezia	8	73400	5000	0	0	0	78400
	Grantet Qeveritare	8	73400	5000				78400
	Të hyrat vetanake							
10	Planifikimi urban	5	57000	5000	0	0	0	62000
	Grantet Qeveritare	5	57000	5000				62000
	Të hyrat vetanake							
	Shëndetësia dhe mirëqenia							

	Grantet Qeveritare	149	1642261	747235	52800	0	30000	2472296
	Të hyrat vetanake		0	100000	0	0	30000	130000
11.1	Administrata	3	30000	2000	0	0	0	32000
	Grantet Qeveritare	3	30000	2000	0	0	0	32000
	Të hyrat vetanake							0
11.2	Shërbimet e shëndetësisë primare	146	1612261	845235	52800	0	60000	2570296
	Grantet Qeveritare	146	1612261	845235	52800	0	60000	2570296
	Të hyrat vetanake							30000
12	Shërbimet sociale	15	138167	50000	5000	50000	50000	293167
	Grantet Qeveritare	15	138167	50000	5000	50000	50000	293167
	Të hyrat vetanake							20000
13	Shërbimet kulturore	12	106427	40000	0	150000	0	296427
	Grantet Qeveritare	12	106427	40000	0	150000	0	296427
	Të hyrat vetanake							50000
14	Arsimi	824	7827029	430000	95000	0	140000	8492029
	Grantet Qeveritare	824	7827029	430000	95000	0	140000	8492029
	Të hyrat vetanake							40000
14.1	Administrata	9	89927	10000	95000	0	20000	60000
	Grantet Qeveritare	9	89927	10000	95000	0	20000	60000
	Të hyrat vetanake							194927
14.2	Arsimi parashkollor dhe qerdhet	41	320422	50000	0	0	0	370422
	Grantet Qeveritare	41	320422	50000	0	0	0	370422
	Të hyrat vetanake							30000
14.3	Arsimi fillor	604	5727600	270000	0	0	0	5997600
	Grantet Qeveritare	604	5727600	270000	0	0	0	5997600
	Të hyrat vetanake							0
14.4	Arsimi i mesëm	170	1689080	100000	0	0	140000	1929080
	Grantet Qeveritare	170	1689080	100000	0	0	140000	1929080
	Të hyrat vetanake							20000
								20000

Planifikimi i të hyrave vetanake për vitin 2026-2029

Burimet e të Ardhurave të Tëhyrave vetanake	viti 2026	viti 2027	viti 2028	viti 2029
Sherbimi i arhivit	1,500	1,500	1,500	2,000
Dokumentet zyrtare ofiqarja(qertifikatat e lindjes)	3,000	3,000	3,000	3,200
Kunorëzimi	4,000	3,500	3,500	3,500
çertifikata te vdekjes	500	1,500	1,500	1,500
Vërtetimi i originalitetit te dokum.	200	200	289	300
T.H. tjera ofiqarje	50,000	52,000	53,000	60,000
Totali i Administrates	59,200	61,700	62,789	70,500
Qiraja nga hapsira publike	15,000	15,000	15,000	15,000
Shfrytëzimi i hapësirës publike	7,410	7,410	7,410	7,410
Reklamati	2,800	2,000	2,800	2,800
Parkim publik	1,200			
Taksë për licenca autotaksive	2,000	600		
Totali i Sherbimeve Publike	28,410	25,010	27,210	27,210
Lejet e Ndertimit	100,000	85,000	90,000	100,000
Lejet mjedisore	2,000	4,000	2,000	2,000
Takse per legalizim objekteve	123,744	114,136	129,000	144,000
Tot.Urbanizmit	225,744	203,136	221,000	246,000
Tatimi në prone	503,696	540,214	545,616	548,344
Tatimi në toke	125,464	151,812	152,571	153,334
Rexhistrimi i automjeteve	118,000	120,000	120,000	120,000
Tot.Ekonomi, Financa	747,160	812,026	818,187	821,678
Fleta poseduese dhe kopje plani	30,000	25,000	30,000	31,000
Barja e pronësisë	35,000	30,000	35,000	36,000
Daljet në teren	24,146	25,000	26,000	30,000
Totali Kadastër- gjeodezi	89,146	80,000	91,000	97,000
Participim nëshëndetësia	80,000	80,000	80,000	85,000
Vërtetime nga QPS-ja	2,800	5,000	2,800	2,800
Tot.Shendetesi	82,800	85,000	82,800	87,800
Të hyrat nga qerdhja	45,000	50,000	50,000	60,000
Të hyrat nga shkollat e mesme	2,000	500	2,000	2,000
total.Arsimit	47,000	50,500	52,000	62,000
Të hyrat nga sht.kultures	1,000	500	1,000	1,000
Te hyrat nga arhivi historik	1,000	200	1,000	1,000
Totali i Kultures	2,000	700	2,000	2,000
Shitja e masës drurore	2,400			
Shenderrimi i tokes buj.-nde.	6,300	10,000	10,000	10,458
Vertetimi per marrje me veprimtari bujqesor	200	200	500	500
Totali i Bujqesise	8,900	10,200	10,500	10,958
Inspektimi i tregut	1,000			
Gjobat nga inspekcioni	1,300	3,000	3,000	5,000
Shiqimi i autotaksive	1,500	400	400	400
Pranimi teknik i lokaleve	2,000	3,000	2,000	2,000
Totali i Inspeksionit	4,300	6,066	5,000	7,000
Totali i përgjithshëm	1,294,660	1,334,338	1,372,486	1,432,146



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prilbjen Me Dana 03-09-2026			
Nr. Llogarit Gj. Broj	Nr. Broj	Shtepi e Proq	Vlera Vendnost
02-	070/01-	882	



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E VITISË / OPŠTINA VITINA /
MUNICIPALITY OF VITI



ZYRA E KRYETARIT

Nr. i Protokollit: _____

Dt: 02.09.2026

Data:	02.09.2026		
Për / Za / To:	Komitetit për Politikë dhe Financa të Kuvendit të Komunës së Vitisë		
Përmes / Preko / Through:	Z. Bekim Azizi Kryesues i Kuvendit Komunal të Vitisë		
Nga:	Z. Sokol Haliti Kryetar i Komunës së Vitisë	znj. Zyrafete Rama Drejtoreshë e DUPMM	
Lënda / Predmet / Subject:	Kërkesë për shqyrtimin dhe rekomandimin e Propozim-vendimit për vënien në shqyrtim publik të Projekt-Hartës Zonale Komunale të Vitisë 2026–2034 dhe procedimin e tij në Kuvendin e Komunës		

K Ë R K E S Ë

Për shqyrtimin, rekomandimin dhe procedimin në kuvend të propozim-vendimit për vënien në shqyrtim publik të projekt-hartës zonale komunale të vitisë 2026-2034

I nderuar z. Azizi, të nderuar anëtarë të Komitetit

Në mbështetje të nenit 52, paragrafit 2, dhe nenit 58, shkronjave h) dhe i), të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, të Statutit të Komunës së Vitisë nr. 01-013/491 dhe të Rregullores nr. 01-013/594 për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, ju paraqesim për shqyrtim Propozim-vendimin për vënien në shqyrtim publik të Projekt-Hartës Zonale Komunale të Vitisë 2026–2034.

Sipas nenit 52, paragrafit 2, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e politikave, planeve, iniciativave dhe dokumenteve të planifikimit strategjik, si dhe për dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës. Për këtë arsye, shqyrtimi paraprak nga Komiteti dhe nxjerrja e rekomandimit për Kuvend përbëjnë hapin procedural të nevojshëm për vazhdimin e kësaj çështjeje.

Projekt-Harta Zonale Komunale e korrigjuar është ridorëzuar në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor më 15.06.2026. Afati i posaçëm dhjetëditor i përcaktuar për dokumentin e korrigjuar ka përfunduar më 25.06.2026 pa u pranuar vendim, njoftim për shtyrje të afatit apo kërkesë tjetër zyrtare. Më 19.08.2026, Komuna e Vitisë i ka dorëzuar dhe protokolluar në Ministri kërkesën për lëshimin e vërtetimit me shkrim të aktit administrativ të miratuar në heshtje dhe ankesën formale kundër heshtjes administrative. Kopjet e të dyja shkresave, me dëshminë e pranimit nga Ministria, i bashkëngjiten kësaj kërkesë.

Propozim-vendimi i paraqitur kufizohet vetëm në zhvillimin e fazës së shqyrtimit publik për tridhjetë (30) ditë kalendarike. Ai nuk paraqet pëlqim të shkruar të Ministrisë, nuk përbën miratim përfundimtar të HZK-së dhe nuk paragjykon vendimmarrjen në procedurat e filluara me dy shkresat e datës 19.08.2026.

Duke u mbështetur në sa më sipër, kërkohet që Komiteti për Politikë dhe Financa:

1. Ta përfshijë këtë çështje në rendin e ditës së mbledhjes së ardhshme të Komitetit;
2. Ta shqyrtojë Propozim-vendimin dhe dokumentacionin procedural të bashkëngjitur;
3. Pas shqyrtimit, t'i rekomandojë Kuvendit të Komunës së Vitisë miratimin e Propozim-vendimit për vënien në shqyrtim publik të Projekt-Hartës Zonale Komunale të Vitisë 2026–2034; dhe
4. Rekomandimin e Komitetit, së bashku me Propozim-vendimin, arsyetimin dhe materialin përcjellës, t'ia procedojë Kuvendit të Komunës për përfshirje në rendin e ditës së mbledhjes së ardhshme, duke respektuar afatet për njoftim dhe shpërndarje të materialeve.

Duke pasur parasysh rëndësinë e HZK-së për zhvillimin e planifikuar, ligjor dhe transparent të territorit të Komunës së Vitisë, kërkohet që kjo çështje të trajtohet pa vonesë të panevojshme dhe në pajtim me procedurat e punës së Komitetit dhe të Kuvendit

Bashkëngjitur:

1. Propozim-vendimi i Kuvendit të Komunës së Vitisë për vënien në shqyrtim publik të Projekt-Hartës Zonale Komunale të Vitisë 2026–2034, me arsyetim;
2. Kërkesa për lëshimin e vërtetimit me shkrim të aktit administrativ të miratuar në heshtje lidhur me miratimin e Projekt-Hartës Zonale të Komunës së Vitisë 2026–2034, e datës 19.08.2026, me dëshminë e pranimi nga Ministria;
3. Ankesa formale kundër heshtjes administrative lidhur me mosnxjerrjen e vendimit për miratimin e Projekt-Hartës Zonale të Komunës së Vitisë 2026–2034, të përmirësuar dhe të ridorëzuar më 15.06.2026, e datës 19.08.2026, me dëshminë e pranimi nga Ministria.

Me respekt,

Sokol Haliti





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E VITISË / OPŠTINA VITINA /
MUNICIPALITY OF VITI

DREJTORIA E URBANIZMIT, PLANIFIKIMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT



KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Nr. i Protokollit: _____

Dt: 19.08.2026

Pratim: Primitje: Data:	19-08-2026
Nr. Komand. / Q. Reg.	02-0706
Emri i...	...
Adresa / Prirje	...
Vlera / Vlerësim	...

Data:	19.08.2026
Për / Za / To:	Z. Bajram Kafexholli, U.D. Sekretar i Përgjithshëm i M...
CC:	Znj. Lendita Radoniqi-Abdiu Divizioni për Planifikim Hapësinor. Z. Servet Spahiu Udhëheqës i Departamentit për Planifikim Hapësinor, Ndërtim dhe Banim.
Përmes / Preko / Through:	Z. Sokol Haliti Kryetar i Komunës së Vitisë
Nga / Od / From:	Znj. Zyrafete Rama Drejtoreshë e Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit
Tema / Predmet / Subject:	Kërkesë për lëshimin e vërtetimit me shkrim të aktit administrativ të miratuar në heshtje lidhur me miratimin e Projekt-Hartës Zonale të Komunës së Vitisë 2026-2034

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING	
Njësia Org. Org. Jevica Dis. Nr. - S2	50-02
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	1943-2/26
Nr. Faqeve Broj Stranica No. pages	1
Data: Datum:	19.08.2026
PRISHTINË/A	



I nderuar **z. Kafexholli,**

Komuna e Vitisë, më 15.06.2026, ka ridorëzuar në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Projekt Hartën Zonale Komunale të Vitisë 2026 – 2034 të përmirësuar, në të cilën janë trajtuar dhe përfshirë ndryshimet dhe plotësimet e kërkuara nga Ministria.

Ridorëzimi është bërë pas takimit sqarues dhe koordinues të mbajtur më 05.06.2026, ndërmjet përfaqësuesve të Komunës së Vitisë, ekipit profesional dhe përfaqësuesve të Ministrisë, me qëllim të sqarimit dhe trajtimit të komenteve të dhëna për Projekt Hartën Zonale Komunale 2026 - 2034.

Në pajtim me nenin 9, paragrafin 2, nënparagrafin 2.3.3 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Ministria, në kuadër të përgjegjësisë së saj, bën miratimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale të Komunës së përmirësuar, e cila përmban ndryshimet dhe plotësimet e kërkuara, brenda dhjetë (10) ditëve nga dita e dorëzimit.

Rrjedhimisht, për dokumentin e përmirësuar dhe të ridorëzuar nga Komuna e Vitisë më 15.06.2026, afati ligjor dhjetëditor ka filluar të rrjedhë më 16.06.2026 dhe ka përfunduar më 25.06.2026, duke marrë parasysh edhe rregullat ligjore për llogaritjen e afateve të përcaktuara në nenin 81 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Brenda afatit të përcaktuar me ligj, Komuna e Vitisë nuk ka pranuar nga Ministria:

- Akt apo njoftim për miratimin e dokumentit;
- Kërkesë tjetër për ndryshim ose plotësim;
- Vendim procedural për shtyrjen e afatit;
- Njoftim për një afat të ri të përfundimit të procedurës; apo
- Ndonjë akt ose njoftim tjetër zyrtar lidhur me Projekt Hartën Zonale të Komunës së Vitisë 2026–2034, të ridorëzuar më 15.06.2026.

Në këtë drejtim, theksojmë se neni 99 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcakton mundësinë dhe kushtet e shtyrjes së afatit për përfundimin e procedurës administrative, ndërsa vendimi procedural për shtyrjen e afatit fillestar dhe data e re e përfundimit duhet t'i njoftohen palës brenda afatit fillestar dhe vendimi duhet të jetë i arsyetuar.

Në rastin konkret, Komuna e Vitisë nuk ka pranuar brenda afatit ligjor asnjë vendim procedural të tillë dhe as ndonjë njoftim për shtyrjen e afatit.

Gjithashtu, për Projekt Hartën Zonale Komunale të Vitisë 2026 – 2034 është siguruar paraprakisht pëlqimi për Vlerësimin Strategjik Mjedisor. Rrjedhimisht, sipas dokumentacionit të dorëzuar nga Komuna, nuk ekziston ndonjë çështje e pazgjidhur që do të pengonte vazhdimin e procedurave të mëtejshme për Projekt Hartën Zonale Komunale.

Pas skadimit të afatit dhjetë (10)-ditor të përcaktuar në nenin 9, paragrafin 2, nënparagrafin 2.3.3 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, më 12.08.2026, Komuna e Vitisë, në frymën e bashkëpunimit dhe koordinimit institucional, i është drejtuar edhe Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë me kërkesë për njoftim lidhur me statusin e shqyrtimit të dokumentit dhe për sqarimin e qëndrimit institucional lidhur me mosveprimin brenda afatit ligjor. Deri në momentin e parashtrimit të kësaj kërkesë, Komuna nuk ka pranuar përgjigje zyrtare.

Në këto rrethana, përveç afatit të posaçëm të përcaktuar me Ligjin Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, zbatohen edhe dispozitat përkatëse të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, lidhur me mosnxjerrjen dhe mosnjoftimin e aktit administrativ brenda afatit ligjor.

Po ashtu, neni 32, paragrafi 4 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcakton se, kur një organ publik vendos pas marrjes paraprake të mendimit, pëlqimit apo miratimit të një organi tjetër publik, ky i fundit duhet ta japë mendimin, pëlqimin apo miratimin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga parashtrimi i kërkesës, përveç kur me dispozita të veçanta është përcaktuar një afat tjetër. Në rastin konkret, afati i posaçëm është përcaktuar me nenin 9, paragrafin 2, nënparagrafin 2.3.3 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor dhe është dhjetë (10) ditë nga dita e dorëzimit të dokumentit të përmirësuar.

Sipas nenit 32, paragrafit 5 të Ligjit Nr. 05/L-031, nëse organi publik, mendimi, pëlqimi apo miratimi i të cilit kërkohet, nuk vepron brenda afatit ligjor, konsiderohet se mendimi, pëlqimi apo miratimi është dhënë dhe është në favor të palës. Në këtë rast, organi publik që nuk ka vepruar brenda afatit dhe organi i tij epror njoftohen për vazhdimin e procedurës në bazë të prezumimit se miratimi është dhënë.

Në veçanti, sipas nenit 100, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031, në rastin kur pala ka kërkuar nxjerrjen e një akti administrativ të shkruar dhe organi publik nuk e njofton palën për aktin administrativ brenda afatit fillestar dhe nuk e njofton shtyrjen e afatit, kërkesa konsiderohet e pranuar në tërësi dhe akti administrativ i kërkuar konsiderohet i miratuar në heshtje, përveç rasteve kur me ligj përcaktohet ndryshe.

Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, në dispozitën që rregullon këtë fazë të procedurës, përcakton afatin e posaçëm prej dhjetë (10) ditësh dhe nuk përmban ndonjë dispozitë që ndalon shprehimisht zbatimin e prezumimit të miratimit në rast të mosveprimit të Ministrisë brenda afatit ligjor. Rrjedhimisht, në mbështetje të nenit 32, paragrafit 5 dhe nenit 100, paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031, me skadimin e afatit dhjetë (10)-ditor pa nxjerrjen dhe njoftimin e ndonjë akti nga Ministria, miratimi i kërkuar për këtë fazë të procedurës konsiderohet i dhënë. Për pasojë, pas njoftimit të Ministrisë dhe organit të saj epror, Komuna ka bazë ligjore për të vazhduar me procedurat e mëtejshme, duke përfshirë vënien e Projekt Hartës Zonale të Komunës së Vitisë në shqyrtim publik.

Po ashtu, në mbështetje të nenit 46, paragrafi 3, në ndërlidhje me nenin 100 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 05/L-031, pala ka të drejtë të kërkojë nga organi publik kompetent vërtetimin me shkrim të përmbajtjes së aktit administrativ të miratuar në heshtje.

Duke marrë parasysh:

- Ridorëzimin e Projekt Hartës Zonale Komunale 2026 – 2034 të përmirësuar më 15.06.2026;
- Trajtimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të kërkuara nga Ministria;
- Afatin e posaçëm prej dhjetë (10) ditësh të përcaktuar me nenin 9, paragrafin 2, nënparagrafin 2.3.3 të Ligjit Nr. 04/L-174;
- Përfundimin e këtij afati më 25.06.2026;
- Mungesën e një akti apo njoftimi të Ministrisë brenda këtij afati;
- Mungesën e një vendimi procedural për shtyrjen e afatit të njoftuar brenda afatit fillestar;
- Dispozitat e nenit 32, paragrafëve 4 dhe 5, nenit 46, paragrafi 3, nenit 81, nenit 99 dhe nenit 100, paragrafëve 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative; dhe
- Faktin se Komuna, edhe pas kalimit të afatit ligjor, ka kërkuar në mënyrë institucionale sqarim dhe njoftim nga Ministria,

KËRKOJMË:

1. Të lëshohet pa vonesë vërtetimi me shkrim për përmbajtjen e aktit administrativ të miratuar në heshtje, me të cilin konfirmohet se miratimi i Ministrisë për Projekt Hartën Zonale të Komunës së Vitisë 2026–2034, të përmirësuar dhe të ridorëzuar më 15.06.2026, konsiderohet i dhënë, në pajtim me nenin 32, paragrafin 5, nenin 46, paragrafin 3, nenin 100, paragrafët 1 dhe 3 dhe nenin 160, paragrafin 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative;
2. Të konfirmohet se, si rrjedhojë e përfundimit të fazës së miratimit nga Ministria, Komuna e Vitisë mund të vazhdojë me procedurat e mëtejshme ligjore për vënien e Projekt Hartës Zonale Komunale në shqyrtim publik për periudhën e përcaktuar me legjislacionin në fuqi;

Duke marrë parasysh se afati ligjor i përcaktuar për këtë fazë të procedurës ka përfunduar që më 25.06.2026, si dhe rëndësinë e Hartës Zonale Komunale për ushtrimin e kompetencave ligjore të Komunës, planifikimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të territorit dhe mbrojtjen e interesit publik, kërkojmë që kjo çështje të trajtohet me prioritet dhe vërtetimi apo akti administrativ përkatës t'i dërgohet Komunës pa vonesë.

Komuna e Vitisë mbetet e përkushtuar ndaj bashkëpunimit dhe koordinimit institucional me Ministrinë dhe ndaj zhvillimit të procedurës së Hartës Zonale Komunale në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi.

Në mungesë të një akti apo përgjigjeje zyrtare nga Ministria, Komuna do të vazhdojë me ushtrimin e të drejtave dhe procedurave institucionale e juridike në dispozicion, duke u mbështetur në dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor dhe Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përfshirë pasojat juridike që këto dispozita i lidhin me mosveprimin e organit publik brenda afatit ligjor.

Bashkëngjitur:

- Dëshmia e dorëzimit të parë të Projekt Hartës Zonale Komunale 2026 – 2034 më 15.04.2026;
- Ftesa nga MMPH me datë 24.04.2026 për prezantimin e Projekt Hartës Zonale Komunale 2026 – 2034 me datë 08.05.2026;
- Komentet e Ministrisë të pranura më 19.05.2026;
- Dëshmia e ridorëzimit të Projekt Hartës Zonale Komunale 2026 – 2034 më 15.06.2026;
- Tabela e trajtimit të komenteve të Ministrisë;
- Pëlqimi për Vlerësimin Strategjik Mjedisor të Projekt Hartës Zonale Komunale 2026 – 2034;
- Emaili i datës 12.08.2026 dhe dëshmia e dërgimit të tij.

Me respekt,



Drejtoreshë e Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E VITISË / OPŠTINA
MUNICIPALITY OF VITI

ZYRA E KRYETARIT



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITI
PRISHITINE

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING

Ngjalla Orig.
Org. Jeshme
Org. Udh.

No. Prot.

Struk. Prot.

Prot. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Org. No.

Nr. i Protokollit: _____

Dt: 19.08.2026

Data:	19.08.2026
Për / Za / To:	Znj. Fitore Pacolli, Ministre e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
Përmes / Preko / Through:	Divizionit për Shqyrtimin e Parashtresave dhe Ankesave Departamenti Ligjor i MMPH-së
CC:	Z. Bajram Kafexholli Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm; Z. Servet Spahiu Udhëheqës i Departamentit për Planifikim Hapësinor, Ndërtim dhe Banim. Znj. Lendita Radoniqi-Abdiu Divizioni për Planifikim Hapësinor
Nga / Od / From:	Sokol Haliti Kryetar i Komunës së Vitisë
Tema / Predmet / Subject:	ANKESË FORMALE KUNDËR HESHTJES ADMINISTRATIVE lidhur me mosnxjerrjen e vendimit për miratimin e Projekt-Hartës Zonale të Komunës së Vitisë 2026-2034, të përmirësuar dhe të ridorëzuar më 15.06.2026

E nderuar znj. Ministre,

Komuna e Vitisë, në cilësinë e palës dhe të autoritetit përgjegjës komunal në procedurën administrative për shqyrtimin, vlerësimin e përputhshmërisë dhe miratimin e Projekt-Hartës Zonale të Komunës së Vitisë 2026-2034, duke u mbështetur në nenin 32, paragrafët 4 dhe 5; nenin 46, paragrafin 3; nenin 100, paragrafët 1 deri 3; nenin 160, paragrafin 2; si dhe në nenet 124; 125, paragrafin 1; 127, paragrafin 4; 128, paragrafin 2; 129; 133 dhe 135 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në nenin 9, paragrafin 2, nënparagrafin 2.3.3 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, paraqet këtë:

ANKESË FORMALE KUNDËR HESHTJES ADMINISTRATIVE

I. Rrethanat faktike dhe zhvillimi i procedurës

Komuna e Vitisë, pas përfundimit të procedurave dhe përgatitjeve të nevojshme, më 15.04.2026 ka dorëzuar në Ministri Projekt Hartën Zonale Komunale të Vitisë 2026 - 2034.

Më datë 24.04.2026 nëpërmjet postës elektronike, Komuna është ftuar nga Ministria për prezantimin e Projekt Hartës Zonale Komunale me datë 08.05.2026, ndërsa më 19.05.2026 ka pranuar komentet dhe vërejtjet e Ministrisë.

Me qëllim të trajtimit të drejtë dhe të plotë të komenteve, Komuna ka kërkuar takim sqarues dhe koordinues me përfaqësuesit e Ministrisë. Takimi është mbajtur më 05.06.2026, me ç'rast janë diskutuar dhe sqaruar çështjet e ngritura përmes komenteve të Ministrisë.

Pas këtij takimi, Komuna e Vitisë, në bashkëpunim me ekipin profesional, ka trajtuar dhe përfshirë komentet e pranuar dhe më 15.06.2026 ka ridorëzuar Projekt Hartën Zonale Komunale të Vitisë 2026 – 2034 të plotësuar dhe të harmonizuar në përputhje me çështjet e diskutuara dhe kërkesat e Ministrisë.

Komuna e Vitisë paraprakisht ka siguruar edhe pëlqimin për Vlerësimin Strategjik Mjedisor të Hartës Zonale Komunale, duke përmbushur edhe këtë komponent të procedurës përkatëse. Rrjedhimisht, çështja e mbetur në pritje ka qenë nxjerrja e vendimit të Ministrisë për miratimin dhe verifikimin e përputhshmërisë së draftit të përmirësuar, si parakusht për procedimin e dokumentit në shqyrtim publik.

Megjithatë, nga data 15.06.2026 e deri në ditën e parashtrimit të kësaj ankese, Komuna e Vitisë nuk ka pranuar:

- Akt administrativ apo vendim për miratimin e dokumentit;
- Akt apo njoftim për refuzimin e tij;
- Kërkesë shtesë për ndryshim apo plotësim;
- Vendim procedural për shtyrjen e afatit;
- Njoftim për ndonjë afat të ri të përfundimit të procedurës; apo
- Ndonjë përgjigje tjetër zyrtare lidhur me Projekt-Hartën Zonale të Komunës së Vitisë 2026–2034, të ridorëzuar më 15.06.2026.

Në përpjekje për ta zgjidhur çështjen nëpërmjet komunikimit dhe bashkëpunimit institucional, më 12.08.2026 Komuna i është drejtuar me kërkesë zyrtare edhe Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë, duke kërkuar njoftim për statusin e lëndës, arsyet e mosveprimit dhe sqarimin e pasojave juridike të kalimit të afatit ligjor.

Edhe pas kësaj kërkesë, deri në momentin e parashtrimit të kësaj ankese, Komuna nuk ka pranuar përgjigje zyrtare.

II. Baza ligjore e ankesës

Sipas nenit 9, paragrafit 2, nënparagrafit 2.3.3 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Ministria duhet ta miratojë Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale të Komunës të përmirësuar, që përmban ndryshimet dhe plotësimet e kërkuara, brenda dhjetë (10) ditëve nga dita e dorëzimit.

Duke qenë se Projekt Harta Zonale Komunale e Vitisë 2026 - 2034, e përmirësuar sipas kërkesave të Ministrisë, është ridorëzuar më 15.06.2026, afati ligjor dhjetëditor ka filluar të rrjedhë më 16.06.2026 dhe ka përfunduar më 25.06.2026, sipas rregullave për llogaritjen e afateve të përcaktuara në Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Pavarësisht përfundimit të këtij afati, Ministria nuk e ka njoftuar Komunën me ndonjë akt administrativ lidhur me dokumentin e ridorëzuar.

Neni 32, paragrafi 4 i Ligjit Nr. 05/L-031 përcakton se, kur një organ publik vendos pas marrjes paraprake të mendimit, pëlqimit apo miratimit të një organi tjetër publik, ky i fundit duhet ta japë atë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga parashtrimi i kërkesës, përveç kur me dispozita të veçanta është përcaktuar një afat tjetër.

Në rastin konkret zbatohet afati i posaçëm dhjetëditor i përcaktuar në nenin 9, paragrafin 2, nënparagrafin 2.3.3 të Ligjit Nr. 04/L-174.

Sipas nenit 32, paragrafit 5 të Ligjit Nr. 05/L-031, nëse organi publik, mendimi, pëlqimi apo miratimi i të cilit kërkohet, nuk vepron brenda afatit ligjor, konsiderohet se mendimi, pëlqimi apo miratimi është dhënë dhe është në favor të palës. Ky efekt përforcohet nga neni 100, paragrafi 1 i të njëjtit ligj, ndërsa, sipas nenit 160, paragrafit 2, rregulli i miratimit në heshtje zbatohet në çdo procedurë administrative, përveç kur zbatimi i tij ndalohej shprehimisht me ligj.

Në kuptim të nenit 125, paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031, ankesa mund të ushtrohet edhe kundër mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative, përkatësisht kundër heshtjes administrative.

Sipas nenit 127, paragrafit 4 të Ligjit Nr. 05/L-031, ankesa kundër heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit të përcaktuar për njoftimin e aktit administrativ.

Në rastin konkret, afati për nxjerrjen dhe njoftimin e aktit ka përfunduar më 25.06.2026, ndërsa kjo ankesë paraqitet më 19.08.2026. Për rrjedhojë, ankesa paraqitet brenda afatit ligjor dhe para përfundimit të periudhës dymujore të përcaktuar me ligj.

Po ashtu, sipas nenit 128, paragrafit 2 të Ligjit Nr. 05/L-031, ankesa ndaj heshtjes administrative mund t'i drejtohet drejtpërdrejt organit epror.

Në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr. 05/L-031, kjo ankesë plotëson kushtet për shqyrtim, pasi është paraqitur nga një subjekt me interes dhe legjitimitet procedural, kundër një mosveprimi administrativ dhe brenda afatit të përcaktuar me ligj.

Sipas nenit 133 të Ligjit Nr. 05/L-031, në rast të ankesës ndaj heshtjes administrative, organi epror shqyrton drejtpërdrejt ankesën, kërkon nga organi përkatës dosjen e plotë të lëndës dhe raportin me shkrim lidhur me arsyet e heshtjes, shqyrton pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e ankesës dhe, përveç rasteve kur ligji përcakton ndryshe, e zgjidh çështjen me aktin e vet përfundimtar.

Mosveprimi i Ministrisë brenda afatit të posaçëm të përcaktuar me Ligjin Nr. 04/L-174 ka krijuar pengesë praktike dhe pasiguri juridike për vazhdimin e procedurës së Hartës Zonale të Komunës, pavarësisht se, sipas dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-031, miratimi i kërkuar konsiderohet i dhënë me kalimin e afatit ligjor.

III. Pranueshmëria dhe afatshmëria e ankesës

Komuna e Vitisë konsideron se kjo ankesë është:

- E lejueshme, pasi Ligji Nr. 05/L-031 njeh shprehimisht ankesën kundër heshtjes administrative;
- E paraqitur nga një subjekt i legjitimuar, pasi Komuna është palë dhe autoritet përgjegjës në procedurën konkrete të HZK-së;
- E afatshme, pasi afati i Ministrisë ka përfunduar më 25.06.2026, ndërsa ankesa paraqitet më 19.08.2026, pra brenda afatit maksimal dymujor të përcaktuar në nenin 127, paragrafin 4; dhe
- E bazuar, pasi pas përfundimit të afatit të posaçëm ligjor prej dhjetë (10) ditësh nuk është nxjerrë dhe Komuna nuk është njoftuar me asnjë akt administrativ apo vendim procedural për shtyrjen e afatit, ndërsa miratimi i kërkuar konsiderohet i dhënë sipas nenit 32, paragrafit 5 dhe nenit 100, paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031.

IV. Kërkesat e Komunës së Vitisë

Duke u mbështetur në faktet dhe dispozitat ligjore të lartpërmendura, Komuna e Vitisë kërkon që:

1. Të konstatohet se kjo ankesë kundër heshtjes administrative është e lejueshme, e afatshme dhe e paraqitur nga një subjekt i legjitimuar;
2. Të konstatohet se, lidhur me Projekt-Hartën Zonale të Komunës së Vitisë 2026–2034, të përmirësuar dhe të ridorëzuar më 15.06.2026, Ministria nuk ka nxjerrë dhe nuk e ka njoftuar Komunën me ndonjë akt administrativ brenda afatit prej dhjetë (10) ditësh të përcaktuar në nenin 9, paragrafin 2, nënparagrafin 2.3.3 të Ligjit Nr. 04/L-174;
3. Të konstatohet se, në mbështetje të nenit 32, paragrafit 5, nenit 100, paragrafit 1 dhe nenit 160, paragrafit 2 të Ligjit Nr. 05/L-031, miratimi i kërkuar nga Ministria për këtë fazë të procedurës konsiderohet i dhënë dhe është në favor të Komunës së Vitisë;
4. Të konfirmohet me shkrim, në aktin që zgjidh këtë ankesë, përmbajtja e miratimit të prezumuar për Projekt-Hartën Zonale të Komunës së Vitisë 2026–2034, në pajtim me nenin 46, paragrafin 3 dhe nenin 100, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 05/L-031;
5. Të konfirmohet zyrtarisht se, si rrjedhojë e miratimit të prezumuar dhe përfundimit të kësaj faze procedurale, Komuna e Vitisë mund të vazhdojë me procedurat e mëtejshme për vënien e Projekt-Hartës Zonale të Komunës së Vitisë 2026–2034 në shqyrtim publik dhe me fazat pasuese, sipas rendit dhe afateve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi;
6. Të njoftohen njësia administrative përgjegjëse dhe strukturat përkatëse të Ministrisë për vazhdimin e procedurës në bazë të prezumimit se miratimi është dhënë, në pajtim me nenin 32, paragrafin 5 të Ligjit Nr. 05/L-031;
7. Akti administrativ që zgjidh këtë ankesë dhe konfirmon miratimin e prezumuar t'i nxirret dhe t'i njoftohet Komunës së Vitisë brenda afatit të përcaktuar në nenin 135 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

V. Efekti juridik dhe konfirmimi i miratimit në heshtje

Neni 32, paragrafi 4 i Ligjit Nr. 05/L-031 përcakton afatin e përgjithshëm për dhënien e mendimit, pëlqimit apo miratimit nga një organ tjetër publik, përveç kur me dispozita të veçanta është përcaktuar një afat tjetër. Në rastin konkret, neni 9, paragrafi 2, nënparagrafi 2.3.3 i Ligjit Nr. 04/L-174 përcakton afatin e posaçëm prej dhjetë (10) ditësh për miratimin e Hartës Zonale të Komunës të përmirësuar.

Sipas nenit 32, paragrafit 5 të Ligjit Nr. 05/L-031, nëse organi publik, mendimi, pëlqimi apo miratimi i të cilit kërkohet, nuk vepron brenda afatit ligjor, konsiderohet se miratimi është dhënë dhe është në favor të palës. Në këtë rast, organi që nuk ka vepruar dhe organi i tij epror njoftohen për vazhdimin e procedurës në bazë të prezumimit se miratimi është dhënë.

Po ashtu, sipas nenit 100, paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031, kur pala ka kërkuar nxjerrjen e një akti administrativ të shkruar dhe organi publik nuk e njofton atë për aktin brenda afatit fillestar dhe as për shtyrjen e afatit, kërkesa vlerësohet e pranuar në tërësi dhe akti i kërkuar konsiderohet i miratuar në heshtje. Ligji Nr. 04/L-174 nuk përmban ndalim shprehimor të këtij efekti, ndërsa, sipas nenit 160, paragrafit 2 të Ligjit Nr. 05/L-031, rregulli i miratimit në heshtje zbatohet në çdo procedurë administrative, përveç kur ndalohet shprehimisht me ligj.

Në mbështetje të nenit 46, paragrafit 3 dhe nenit 100, paragrafit 3 të Ligjit Nr. 05/L-031, Komuna ka të drejtë të marrë vërtetimin me shkrim të përmbajtjes së aktit të miratuar në heshtje. Rrjedhimisht, kjo ankesë kërkon vetëm konfirmimin zyrtar se miratimi i Ministrisë për fazën para shqyrtimit publik konsiderohet i dhënë dhe se Komuna mund të vazhdojë procedurën. Parashtrimi i ankesës nuk përbën heqje dorë nga ky efekt juridik dhe nuk nënkupton miratimin përfundimtar të HZK-së nga Kuvendi i Komunës apo anashkalimin e fazave të tjera të përcaktuara me ligj.

VI. Çështja e kompetencës për shqyrtimin e ankesës

Nëse organi të cilit i është drejtuar kjo ankesë vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston një organ epror në kuptimin procedural, ose se kompetenca për shqyrtimin e saj i takon një organi apo njësie tjetër, kërkojmë që ankesa, së bashku me dokumentacionin shoqërues, t'i përcillet pa vonesë organit kompetent, pa cenuar datën e parashtrimit të saj dhe pa i shkaktuar Komunës pasoja procedurale për shkak të çështjes së kompetencës. Komuna e Vitisë të njoftohet zyrtarisht për çdo përcjellje të tillë dhe për organin tek i cili është transferuar lënda për shqyrtim.

VII. Ruajtja e së drejtës për mbrojtje gjyqësore

Në rast të moszgjidhjes së ankesës dhe vazhdimin të mosveprimit administrativ, Komuna e Vitisë rezervon të drejtën të shfrytëzojë të gjitha mjetet juridike dhe institucionale në dispozicion, përfshirë ushtrimin e mbrojtjes gjyqësore në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-182 për Konfliktet Administrative.

Duke pasur parasysh rëndësinë e Hartës Zonale të Komunës për ushtrimin e kompetencave ligjore të Komunës së Vitisë, zhvillimin hapësinor, urban, ekonomik dhe investiv, sigurinë juridike të qytetarëve dhe interesin publik, kërkojmë që kjo ankesë të trajtohet me prioritet dhe të nxirret akti përkatës pa vonesë të mëtejshme.


Komuna e Vitisë mbetet e përkushtuar ndaj bashkëpunimit institucional dhe përfundimit të kësaj procedure në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi.

Bashkëngjitur:

- Dëshmia e dorëzimit të parë të Projekt Hartës Zonale Komunale 2026 – 2034 më 15.04.2026;
- Ftesa nga MMPH me datë 24.04.2026 për prezantimin e Projekt Hartës Zonale Komunale 2026 – 2034 me datë 08.05.2026;
- Komentet e Ministrisë të pranura më 19.05.2026;
- Dëshmia e ridorëzimit të Projekt Hartës Zonale Komunale 2026 – 2034 më 15.06.2026;
- Tabela e trajtimit të komenteve të Ministrisë;
- Pëlqimi për Vlerësimin Strategjik Mjedisor të Projekt Hartës Zonale Komunale 2026 – 2034;
- Kërkesa drejtuar Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm më 12.08.2026 dhe dëshmia e dërgimit;
- Kërkesa për lëshimin e vërtetimit me shkrim të aktit administrativ të miratuar në heshtje, e datës 19.08.2026.

Me respekt,

 Sokol Haliti


Kryetar i Komunës së Vitisë

SHTOJCA 1

KONSTATIM I EKIPIT PROFESIONAL

mbi statusin e trajtimit të komenteve në Projekt Hartën Zonale të Komunës së Vitisë 2026–2034

QËLLIMI:

Kjo shtojcë paraqet krahasimin profesional ndërmjet komenteve të Ministrisë në vlerësimin e dytë dhe dokumentit “Trajtimi i komenteve nga Komuna”, të dorëzuar së bashku me Projekt-HZK-në e plotësuar më 15.06.2026. Analiza konstaton nëse secili koment ka bazë në legjislacionin specifik për HZK-në dhe nëse është trajtuar më parë përmes korrigjimit, plotësimit, sqarimit ose arsyetimit profesional.

KONSTATIMI KRYESOR:

Të gjitha çështjet e evidentuara në shkresën e Ministrisë kanë qenë objekt trajtimi në përgjigjen komunale dhe në paketën e ridorëzuar më 15.06.2026. Për disa pika Ministria ka pranuar plotësimin; për disa ka konstatuar mangësi të mbetura; ndërsa për disa ekziston mospajtim profesional ose juridik. Prandaj, shprehja “nuk është plotësuar kërkesa” nuk duhet barazuar automatikisht me “komenti nuk është trajtuar”.

VËREJTJE PËR BAZËN JURIDIKE:

Për HZK-në, akti specifik është U.A. MMPH nr. 24/2015. Referencat e shkresës të U.A. MMPH nr. 01/2015 për planet rregulluese të hollësishme nuk janë baza e drejtpërdrejtë për strukturën e HZK-së; kërkesat duhet të vlerësohen sipas UA 24/2015, Ligjit nr. 04/L-174, NTPH-së nr. 08/2017 dhe akteve sektoriale përkatëse.

GAZETA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË KOSOVËS[Shqip](#) | [English](#) | [Srpski](#) | [Türkçe](#) | [Bosanski](#) | [Rreth zyrës](#) | [Abonohu](#) | [Statistikat](#)

FILLIMI

KATEGORIZIMI I AKTEVE

UDHËZIM ADMINISTRATIV MMPH - NR. 24/2015 MBI ELEMENTET DHE KËRKESAT
THEMELORE PËR HARTIMIN, ZBATIMIN DHE MONITORIMIN E HARTËS ZONALE TË
KOMUNËS

Lloji i aktit: Udhëzime Administrative
Numri i aktit: MMPH-24/2015
Institucioni: Ministria e Mjedisit e
Planifikimit Hapësinor

Data e publikimit: 31.12.2015

ROLI INSTITUCIONAL I KOMUNËS DHE I MINISTRISË:

Sipas ndarjes së kompetencave të përcaktuar me Ligjin nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor dhe aktet nënligjore përkatëse, autoriteti përgjegjës komunal është bartës i procesit të hartimit të Hartës Zonale të Komunës dhe është përgjegjës për përcaktimin e zgjidhjeve të planifikimit në nivel lokal, në përputhje me PZHK-në, nevojat e territorit dhe kompetencat vetanake të Komunës. Roli i Ministrisë në këtë fazë është të vlerësojë ligjshmërinë dhe përputhshmërinë e Projekt-HZK-së me dokumentet e planifikimit hapësinor të nivelit qendror, përfshirë Planin Hapësinor të Kosovës, Hartën Zonale të Kosovës kur ajo është në fuqi, planet hapësinore për zona të veçanta, si dhe me kërkesat detyruese ligjore. Ky rol i kontrollit dhe koordinimit nuk duhet të shndërrohet në zëvendësim të autoritetit hartues komunal, në bashkëhartim të vazhdueshëm të dokumentit ose në imponim të zgjidhjeve konkrete lokale për çështjet të cilat nuk mandatohen as me dokumentet të planifikimit hapësinor të nivelit qendror e as me kornizen ligjore në fuqi. Rrjedhimisht, çdo kërkesë për ndryshim duhet të mbështetet në një dispozitë konkrete ligjore, normë teknike ose mospërputhje të identifikueshme me dokumentet qendrore, duke i'u referuar paragrafeve specifike të këtyre dokumenteve. Monitorimi i zbatimit të HZK-së, kur ushtrohet sipas ligjit, duhet të dallohet nga drejtimi i procesit të hartimit, i cili mbetet përgjegjësi e autoritetit komunal.

A. KOMENTET E PËRGJITHSHME DHE PIESA TEKSTUALE

Nr.	Komenti / çështja	Vlerësimi i bazës	Statusi i trajtimit	Referenca në përgjigjen e 15.06.2026	Konstatimi i ekipit profesional
P-1	Harmonia e HZK-së me PZH-K 2023–2031.	I drejtë në parim; buron nga neni 5 i UA 24/2015.	Trajtuar dhe arsyetuar	Dokumenti i trajtimit, f. 2–3	Është konfirmuar mbështetja në PZH-K, Kornizën e Zhvillimit Hapësinor dhe tërësitë urbane. Kërkesa është trajtuar në dorëzimin e 15.06.2026.
P-2	Respektimi i kufijve ndërtimorë dhe dendësisë mesatare deni 200 b/ha.	I drejtë si kontroll i harmonisë me PZH-K; kërkon verifikim hartografik dhe illogaritje.	Trajtuar; pjesërisht kundërshtuar për ZB-6	f. 2 dhe 15–16	Kufiri 200 b/ha është respektuar për zonat e zakonshme; për ZB-6 është dhënë arsyetimi i veçantë sipas kategorisë së sipërfaqes urbane qendrore.
P-3	Zonat/kushtet të përpunhen me Kornizën, qëllimet dhe objektivat e PZH-K-së.	I drejtë; UA 24/2015, neni 5.	Trajtuar dhe arsyetuar	f. 2–4	Zonimi është lidhur me Hartën 31 dhe tërësitë Q, V, P, J, L, PL1 e PL2; komentit është trajtuar.
P-4	Kushtet e banimit sipas dendësisë, tipologjisë dhe parcelës.	I drejtë; NTPH, Kap. IV, nenet 1–2.	Trajtuar	f. 5	Janë rishikuar dendësia, tipologjia, parcela, indeksët, etazhitei dhe distancat.
P-5	Shkurtimi i tekstit voluminoz.	Rekomandim redaktorial, jo mangësi e matshme ligjore pa identifikim konkret.	Trajtuar	f. 5	Janë reduktuar përsëritjet dhe përshkrimet jo të domosdoshme.
P-6	Marjia parasysh e rekomandimeve të VSM-së.	I drejtë; kërkesë ndërkëtoriale mjedisore.	Trajtuar	f. 6	Ekipi ka deklaruar integrimin e rekomandimeve të VSM-së.
P-7	Ndryshimet tekstuale të reflektohen në harta.	I drejtë; kërkesë konsistence tekst–hartë.	Trajtuar	f. 6 dhe 30–40	Ndryshimet janë përcjellë në pjesën hartografike dhe janë dhënë përgjigje për secilin hartë.
T-1	Hyjja, faqet 19–27, të jetë e shkurtrë dhe e qartë.	Qëllimi është i arsyeshëm, por shkresa citon UA 01/2015 për PRRH; për HZK baza e drejtëpërdrejtë është UA 24/2015.	Trajtuar/qartësuar	f. 7	Janë sqaruar pjesët paraprahe që plotësohen pas shqyrtimit publik dhe është paraparë finalizimi redaktorial.
T-2	Arsyetimi të përmbajtë bazën ligjore, mjedisore dhe ekonomike.	Përmbajtësihi i drejtë; referenca të UA 01/2015 nuk është baza specifike e HZK-së.	Trajtuar	f. 8	Arsyetimi është lidhur me Ligjin 04/L-174, PZH-K-në dhe aspektet ligjore, hapësinore, mjedisore e ekonomike.
T-3	Lista e zonave/simbolet sipas NTPH; industri, transport, bujqësi dhe zonat e mbrojtura.	I drejtë për standardizim; baza duhet lexuar me UA 24/2015 dhe NTPH.	Trajtuar; disa elemente kërkojnë verifikim final	f. 8–9	Janë harmonizuar emërtimet, HILUCS, legjenda dhe lidhja tekst–grafikë. Çështja e zonave të mbrojtura është sqaruar veçmas.
T-4	Zonat e destinuara, popullsia totale dhe kufiri 200 b/ha.	I drejtë për kontrollin e kapacitetit; komentit përziehet me interpretim demografik që duhet provuar me tabelë illogaritëse.	Trajtuar dhe arsyetuar	f. 9–11	Është dhënë lidhja me PZH-K-në, projektionet demografike dhe shpërndarjen urbane/rurale. Për KPF duhet të theksohet se trajtimi është bërë, edhe kur Ministria nuk e ka pranuar përfundim.
T-5	ZB-1–ZB-3: dendësitë, shfrytëzimet dhe harmonizimi tekst–tabelë, përqindjet.	I drejtë sipas UA 24/2015 neni 12 dhe NTPH; vërejtja për përqindjet është teknike.	Trajtuar; Ministria e vlerëson ende të paharmonizuar	f. 12–13	Komuna ka rishikuar kategoritë dhe ka arsyetuar zgjedhjen e shfrytëzimeve. Mospajtimi i dytë lidhet me rezultat, jo me mungesë trajtimi.
T-6	Figura 4 – këndi 45° nuk vlen për banimin e ulet.	Koment teknik i drejtë.	Pranuar dhe zbatuar	f. 13	Figura është larguar/përmirësuar; edhe shkresa e dytë e pranon plotësimin.
T-7	Tabelat 17–19 të harmonizohen me komentin 5.	I drejtë si kërkesë konsistence.	Pranuar dhe zbatuar	f. 13	Tabelat janë përmirësuar; Ministria e ka konsideruar kërkesën të plotësuar.
T-8	ZB-4–ZB-6: shfrytëzimet dhe Tabela 20 të harmonizohen.	I drejtë si kontrolli formal sipas UA 24/2015/NTPH.	Trajtuar; mospajtim i mbetur për ZB-4/ZB-5	f. 13–15	Është dhënë arsyetimi dhe janë bërë rishikime; vlerësimi i dytë pohon mospërputhje të mbetur, por jo mungesë trajtimi.
T-9	Tabelat 23–24 të përmirësohen pas komentit 5.	I drejtë si kërkesë konsistence.	Pranuar dhe zbatuar	f. 15	Komenti është trajtuar dhe tabelat janë përmirësuar.

T-10	Të largohet ZB-6.	I diskutueshëm: NTPH lejon kategori urbane qendrore, por HZK duhet njëkohësisht të dëshmojë harmoninë me PZHK-në dhe kufirin 200 b/ha.	Trajtuar – nuk është pranuar	f. 15–16 dhe 36	Është dhënë arsyetim profesional dhe referencë në NTPH; në takim më 05.06.2026 ishte raportuar dakordim për mbajtjen e ZB-6. Kërkohej që Ministria ta vlerësojë arsyetimin, jo ta cilësojë si të patrajtuar.
T-11	Zonat për shfrytëzim të përzier të dallohen nga banimi dhe të harmonizohen me PZHK-në.	I drejtë nëse shfrytëzimet janë identike ose harta bie ndesh me PZHK-në.	Trajtuar	f. 17	Kapitulli është rishikuar; shkresa e dytë kundërshkon rezultatin, por përgjigjia ekziston.
T-12	ZK-1/ZK-2: shfrytëzimet, tabela, zejtaria/hoteli dhe largimi i bonuseve.	Kryesisht i drejtë sipas nenit 12 të UA 24/2015 dhe NTPH.	Trajtuar; pjesërisht i pranuar nga Ministria	f. 17	Kapitulli dhe tabelat janë harmonizuar; pikat e mbetura duhet të kontrollohen teknikut, por komentit është trajtuar.
T-13	ZI-1/ZI-2: harmonizimi, parcela minimale dhe kushtet për energji.	I drejtë dhe specifik; kërkon njëtrajshmëri dhe kushte sigurie.	Trajtuar; pjesërisht i pranuar	f. 17–18	Janë rishikuar shfrytëzimet dhe tabelat. Ministria identifikon paqartësi të mbetura, që duhet ndarë nga pretendimi se nuk është trajtuar.
T-14	Figura 10 – distanca 6 m banim–industri.	Koment teknik i drejtë.	Pranuar dhe zbatuar	f. 18	Figura është rishikuar; shkresa e dytë konstaton largimin e distancës.
T-15	Bonuset e zonimit në zonat industriale.	I drejtë nëse nuk ka bazë/përcaqim të qartë.	Pranuar dhe zbatuar	f. 18	Teksti është larguar; Ministria e pranon plotësimin.
T-16	Zonat rekreative-turistike: përshtirimi dhe shfrytëzimet.	I drejtë për harmonizim me PZHK dhe nenin 12 të UA 24/2015.	Pranuar dhe zbatuar	f. 18–19	Kapitulli është rishikuar në tërësi; Ministria e konsideron kërkesën të plotësuar.
T-17	Bonuset e zonimit në ZrT.	I drejtë në mungesë të bazës së veçantë.	Pranuar dhe zbatuar	f. 20	Teksti është larguar; Ministria e pranon plotësimin.
T-18	ZKT dhe stacioni/parkingjet të trajtohen të infrastruktura e transportit.	I drejtë si kërkesë strukturore dhe e përputhjes me hartën.	Trajtuar	f. 20 dhe 24	Kapitulli është rishikuar dhe stacioni është orientuar të infrastruktura rrugore/transporti. Shkresa e dytë e quan të paplotësuar pa e rritur këtë përgjigje me referencë konkrete.
T-19	Zona bujqësore të rishikohet sipas PZHK-së; të hiqet teksti nga Shtërpa.	I drejtë dhe material; përmbajtja e komunës tjetër është gabim i qartë.	Trajtuar	f. 20–21	Teksti i huaj është larguar dhe kapitulli është përcaktuar për Vitinë. Ministria pranon vetëm largimin; prandaj ka mospajtim mbi thellësinë e rishikimit, jo mungesë trajtimi.
T-20	Zona vjore sipas PZHK dhe NTPH Kap. II, neni 2.	I drejtë.	Trajtuar	f. 21	Shfrytëzimet janë rishikuar sipas funksionit primar pyjor; Ministria thotë se kapitulli nuk është rishikuar, çka duhet verifikuar me versionin e HZK-së së 15.06.2026.
T-21	Sipërfaqet ujore: rrjedhat/burimet, kategoritë dhe shfrytëzimet.	I drejtë dhe specifik; kërkon inventar lokal dhe kushte mbrojtëse.	Trajtuar; kërkon verifikim final	f. 21–22	Komuna ka specifikuar Moravën e Binçës dhe rrjedhat përcjellëse dhe ka kufizuar shfrytëzimet. Shkresa e dytë kërkon më shumë rrjedha/burime; kjo është kërkesë plotësuese mbi trajtimin ekzistues.
T-22	Zona ushtarake e sigurisë: arsyetimi dhe trajtimi specifik.	I drejtë; komuna nuk mund të caktojë kushte për një zonë që nuk e menaxhon.	Pranuar dhe zbatuar	f. 22 dhe 32, 35	Zona është mbajtur vetëm si identifikim dhe kushtet janë larguar; në takimin e 05.06.2026 ishte dakorduar mbetja e saj.
T-23	Zona e mbrojtur: specifikimi i zonave të natyrës/trashëgimisë/zonës së veçantë.	Pjesërisht i drejtë; zona mund të paraqitet vetëm kur ka bazë ligjore dhe të dhëna zyrtare. Nuk duhet shpikur zonë e shpallur.	Trajtuar me sqarim; Ministria kërkon plotësim	f. 22–23	Kushtet janë larguar dhe është lënë klauzolë për trajtim sipas legjislacionit nëse zona shpallet/evidentohet. Për zonat e veçanta dhe trashëgiminë duhet përdorur inventari zyrtar.
T-24	Zonat mbishtrësore vetëm kur nevojiten dhe në sipërfaqe specifike.	I drejtë sipas nenit 13 të UA 24/2015.	Trajtuar dhe arsyetuar	f. 23–24	Janë shpëlluar të dhënat preliminare dhe nevoja për studime lokale. Ministria nuk e pranon rezultatin, por komentit është trajtuar.
T-25	Infrastruktura rrugore/publike/sociale të rishikohet; ligji i ri, emërtimi i ministrisë dhe varrezat.	I drejtë sipas nenëve 14–15; përditësimi i ligjit/emërtimit është teknik. Lokacionet kërkojnë bazë zyrtare.	Trajtuar; plotësim i mbetur	f. 24	Kapitujt janë ristrukturuar dhe elementet janë zhvendosur. Shkresa e dytë shton përditësim konkret, që duhet evidentuar si korrigjime të mbetura.
T-26	Nevoja për 8 PRRH; PZHK nuk i parashihet dhe paraqesin barrë.	I diskutueshëm: neni 17 i Ligjit 04/L-174 lejon PRRH kur nevojitet detajim; numri duhet arsyetuar dhe priorizuar.	Trajtuar – nuk është pranuar	f. 25–26	Komuna ka dhënë arsyetim ligjor, funksional dhe fazim sipas prioriteteve/buxhetit. Ky është mospajtim planifikues, jo mos-trajtim.
T-27	Vendbanimet joformale të largohen; të mbetet vetëm konstatimi se nuk ka.	Kërkesa për konstatim të shkurtyr është e arsyeshme; dokumentimi i mos-ekzistencës nuk është shkëlqej.	Trajtuar dhe arsyetuar	f. 27–28	Kapitulli shpëllon se nuk ka vendbanime joformale; shkresa e dytë pranon mundësinë e një fjalle të shkurtyr.
T-28	Plani i Veprimtimit sipas nenit 19 dhe PZHK-së.	I drejtë.	Pranuar dhe zbatuar	f. 29	Janë përfshirë aktivitetet e PZHK-së dhe aktivitetet plotësuese; Ministria e konsideron kërkesën të plotësuar.

B. PJESA HARTOGRAFIKE

Nr.	Konenti / çështja	Vlerësimi i bazës	Statusi i trajtimit	Referenca në përfundim e 15.06.2026	Konstatimi i ekipit profesional
H-0	Kërkesa e përgjithshme: UA 24/2015, UA 03/2019, reflektimi tekst-hartë dhe korrigjimi Gjakovë→Viti.	I drejtë.	Pranuar dhe zbatuar	f. 30	Komuna deklaron trajtim sipas kërkesës; gabimi i emërimit është korrigjim teknik.
H-1	Neni 24 – Harta e të dhënave bazë.	I drejtë; hartë bazë e detyrueshme.	Trajtuar	f. 31	Është përfshirë; vlerësimi i dytë e shënon përmbajtjen pjesërisht.
H-2	Neni 25 – sipërfaqet/ndërtimet me rëndësi; simbolika, trashëgimia dhe Bondsteel.	I drejtë sipas UA 24/2015 dhe NTPH.	Pranuar dhe zbatuar	f. 31	Është rregulluar sipas kërkesës; Ministria e pranon plotësimin.
H-3a	Neni 26 – emërtimet dhe simbollogjia HILUCS/KHRRP; harmonia me tabelën e zonave.	I drejtë si standardizim.	Trajtuar	f. 31–32	Komuna ka verifikuar nomenklaturën HILUCS/INSPIRE dhe harmonizimin. Ministria mbetet në qëndrimin se nuk është plotësuar; nevojitet kontrolli GIS shtresë-më-shtresë.
H-3b	Zgjerimet në Terstenik, Pozheran, Gushicë, Verban, Radiojocë dhe Viti.	I drejtë kur ka devijim nga PZHK; gjendja faktike ose vendimi komunal nuk e zëvendëson automatikisht harmoninë me PZHK.	Trajtuar; disa korrigjuar, disa arsyetuar	f. 32–33	Pozheran/Verbani janë kthyer; Gushicë/Radiojocë janë arsyetuar; Viti është sqaruar si konfuzion ngjyrash; Bondsteel sipas gjendjes faktike/takimit.
H-3c	Zonat e energjisë në Devajë, Zhti dhe Slatinë.	I diskutueshëm: HZK duhet të zbatojë PZHK-në; boniteti i tokës vetëm nuk mjafton për ndryshim të përshkrahës. Mund të arsyetohet përdorimi i përkohshëm nëse lejohet.	Trajtuar – arsyetuar/varur nga verifikimi digjital	f. 33	Për secilin lokacion është dhënë arsyetim; Ministria nuk e pranon. Kjo nuk është mos-trajtim.
H-3d	ZK-1 në Pozheran.	I drejtë nëse PZHK e përcakton banimin; gjendja faktike komerciale duhet dokumentuar dhe trajtuar brenda kompetencës së HZK-së.	Trajtuar – arsyetuar	f. 34	Është argumentuar me veprimtaritë ekzistuese dhe mungesën e zgjerimit të kufirit.
H-3e	ZSH në Slatinë/Radiojocë dhe ZT-2/ZSH në Verban.	Pjesërisht i drejtë; kërkohet bazë në PZHK ose vendim/akt sektorial i vlefshëm.	Trajtuar; disa korrigjuar, disa arsyetuar	f. 34–35	Varrezat/parku janë lidhur me vendime komunale; deponitë me gjendjen dhe dokumentet paraprahe. ZT-2 mbetet pikë mospajtimi.
H-3f	Sipërfaqja ujore në Binçë.	I diskutueshëm: projekti i pendës mund të justifikojë rezervim vetëm me bazë planifikuese/fizibilitet të vlefshëm.	Trajtuar – nuk është pranuar	f. 35	Është dhënë referencë në PZHK 2010–2020 dhe studim fizibiliteti; Ministria kërkon bazë të re/pas PZHK-së.
H-3g	ZT-1/ZK-1 veripërdim të Vitës dhe ZT-1 në Binçë; simbolet ZSH.	I drejtë si kontroll i harmonisë dhe lexueshmërisë.	Pranuar dhe zbatuar	f. 35	Zonat/simbolet janë rregulluar; Ministria e pranon harmonizimin e simboleve, por mban kundërshtim për ZT-1.
H-3h	Bondsteel dhe zvogëlimi i kufirit në Gjylekar/Verban.	I drejtë për harmonizim; Bondsteel kërkon koordinim me autoritetin kompetent.	Trajtuar	f. 35–36	Gjylekar/Verbani janë korrigjuar; Bondsteel është arsyetuar me gjendjen faktike dhe takimin 05.06.2026.
H-3i	Largimi i ZB-6 nga harta.	I diskutueshëm për të njëjtat arsye si T-10.	Trajtuar – nuk është pranuar	f. 36	Është dhënë arsyetim dhe është shënuar dakordimi në takimin e 05.06.2026.
H-3j	Brezat mbrojtës përgjatë trupave ujore.	I drejtë; dimensionet dhe kompetencat duhet të reflektojnë ligjin për Ujërat dhe kushtet urbane.	Trajtuar – arsyetuar	f. 36	Janë dhënë referenca në nenet 46 dhe 49 dhe dallimi zonë urbane/jashtë saj; Ministria kërkon paraqitje grafike më të plotë.
H-3k	Brezi kundër zjarrit në kufi me RMV.	I drejtë sipas PZHK-së.	Pranuar dhe zbatuar	f. 36	Është rregulluar; Ministria e pranon plotësimin.
H-3l	Korridoret transportuese të planifikuara.	I drejtë.	Trajtuar	f. 36	Komuna deklaron se janë paraqitur; Ministria kërkon dallueshmëri dhe plotësi më të madhe.
H-4	Neni 27 – harta e tokës bujqësore, boniteti dhe shtresat bazë.	I drejtë.	Pranuar dhe zbatuar	f. 36–37	Janë shtuar klasat e bonitetit dhe elementet e kërkuara; Ministria e konsideron kërkesën të plotësuar.

H-5	Neni 28 – infrastruktura rrugore, lëvizja jo e motorizuar, transporti publik dhe kategorizimi.	I drejtë.	Trajtuar, pjesërisht i pranuar	f. 37	Hartat janë plotësuar; në vlerësimin e dytë mbetet korrigjimi i kategorive sipas NTPH-së.
H-6	Neni 29 – infrastruktura publike/sociale, parqet, fushat dhe varrezat.	I drejtë; sipërfaqet duhet të paraqiten sipas shkalës dhe të dhënave të disponueshme, jo vetëm me simbol kur kërkohet poligon.	Trajtuar; Ministria e quan të paplotësuar	f. 37	Komuna deklaron rregullim; vlerësimi i dytë kërkon paraqitje sipërfaqësore dhe korrigjim legjende. Kjo është mangësi e pretenduar e mbetur, jo mungesë trajtimi.
H-7a	Neni 30 – ujesjellësi dhe kanalizimi në zonat rurale.	I drejtë; duhet harmoni me PZH dhe të dhëna sektorale.	Trajtuar	f. 37-38	Hartat tematike janë ndare dhe plotësuar sipas planifikimeve të disponueshme; Ministria mbetet në vlerësim negativ.
H-7b	Drenazhimi.	I drejtë.	Trajtuar	f. 38	Komuna deklaron hartë të konsoliduar me masa dhe kushte; kërkohet verifikim GIS për plotësimin.
H-7c	Rrjeti i ujitjes.	Pjesërisht i drejtë: mungesa në PZHK ngre çështje harmonie; HZK mund të detalojë, por jo të ndryshojë orientimin bazë pa arsyetim/akt.	Trajtuar – pjesërisht korrigjuar	f. 39	Poligonet e ujitjes janë larguar nga zonat e banimit dhe është dhënë arsyetim. Ministria nuk e pranon planifikimin.
H-7d	Infrastruktura termike.	I drejtë nëse paraqitet si plan i vendosur pa bazë në PZHK/fizibilitet; mund të mbahet vetëm si mundësi e kushëzuar dhe e arsyetuar.	Trajtuar – nuk është pranuar	f. 39	Komuna ka dhënë arsyetim dhe thotë se ka konsideruar vërejtjen; Ministria kërkon fizibilitet ose strategji lokale.
H-7e	Energjia elektrike dhe telekomunikacioni: simbolika/harmonia me PZHK.	I drejtë.	Pranuar dhe zbatuar sipas Komunës	f. 39	Janë rregulluar dhe detajuar; Ministria vazhdon t'i vlerësojë të paplotësuar, prandaj duhet kontroll teknik i legjendës dhe shtresave.
H-7f	Harta e grumbullimit/deponimit të mbeturinave; titulli dhe lokacionet; largimi i Klokotit.	I drejtë.	Trajtuar: Klokoti i korrigjuar	f. 40	Harta është plotësuar dhe Klokoti është larguar. Ministria pranon këtë të fundit, por pretendon se mungon ende harta/lokacioni; nevojitet verifikim i paketës së dorëzuar.
H-8	Neni 31 – harta e zonave mbishtrësore dhe legjenda.	I drejtë.	Pranuar dhe zbatuar	f. 40	Kodet dhe emërtimet janë sqaruar. Ministria e konsideron kërkesën të plotësuar.
H-9	Neni 32 – harta e vendbanimeve joformale.	Nuk kërkohet hartë tematike me përmbajtje kur zyrtarisht nuk ka vendbanime joformale; duhet konstatim i qartë.	Trajtuar	f. 40	Komuna ka konstatuar mungesën e vendbanimeve joformale; përputhet me qëndrimin e Ministrisë për një fjalë të shkurtër.
H-10	Neni 33 – harta e PRRH-ve dhe 8 zonat e propozuara.	Harta kërkohet nëse HZK cakton zona për PRRH; nevoja dhe numri duhet arsyetuar, por PZHK-ja që nuk i liston nuk i ndalon automatikisht.	Trajtuar – nuk është pranuar	f. 40-41 dhe 25-26	Komuna ka sqaruar synimin për hartim fazor sipas nevojës; Ministria mban kundërshtimin. Ky është mospajtim profesional/planifikues.

C. KONKLZIONI PËR KOMITETIN PËR POLITIKË DHE FINANCA

1. Trajtimi është dokumentuar.

Dokumenti komunal i ridorëzuar më 15.06.2026 përmban përgjigje për secilën kategori të komenteve dhe referenca për korrigjimet, sqarimet ose arsyetimet.

2. Ekzistojnë tri kategori rezultatesh.

- Ka komente të pranuar dhe të zbatuara;
- Komente të trajtuara me plotësime ku Ministria pretendon mangësi të mbetura; dhe
- Komente të trajtuara, por të mospranuar nga Komuna për arsye profesionale ose juridike.

3. Vlerësimi i dytë nuk duhet të mohojë vetë aktin e trajtimit.

Kur përgjigjja dhe arsyetimi janë dhënë, formulimi i saktë është se Ministria “nuk e pranon trajtimin/arsyetimin” ose “kërkon plotësim shtesë”, jo se komenti nuk është trajtuar.

4. Çështjet e mbetura duhet të individualizohen.

Për çdo pretendim të mbetur Ministria duhet të tregojë elementin konkret, nenin përkatës, hartën/shtresën dhe korrigjimin e kërkuar, në mënyrë që procesi të jetë i verifikueshëm dhe proporcional.

5. Qëndrimi profesional.

Ekipi profesional konstaton se paketa e 15.06.2026 ka qenë përgjigje e strukturuar ndaj vlerësimit të parë. Mospajtimet e mbetura nuk e zhbëjnë faktin e trajtimit dhe duhet të zgjidhen me shqyrtim teknik të versionit të dorëzuar, procesverbalit të takimit të 05.06.2026 dhe shtresave GIS përkatëse.

D. Burimet e shqyrtuara

- Shkresa e Ministrisë nr. 3298-2/26 (vlerësimi i dytë; në kopjen e skanuar figuron data e dokumentit 10.07.2026 dhe vula e protokollimit 31.08.2026).
- Dokumenti “Trajtimi i Komenteve nga Komuna”, i lidhur me ridorëzimin e Projekt-HZK-së më 15.06.2026.
- Ligji nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor.
- U.A. MMPH nr. 24/2015 për elementet dhe kërkesat themelore të HZK-së.
- U.A. MMPH nr. 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor.
- U.A. (QRK) nr. 03/2019 për bazën e të dhënave dhe dorëzimin e dokumenteve/të dhënave.

Për ekipin profesional:

Zyrafete Rama

Drejtoreshë e Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Datë: 07.09.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

Pranimat - Pranimja Me Datë 02-09-2026			
Nr. Llogarit Org. Buj	Nomen Pro	Adresa Poste	Vlera Vendoset
02-	035	102-	873



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në pajtim me dispozitat e nenit 58, pika h të Ligjit mbi Vetëqeverisjen nr. 03/L-040 dhe nenit 50, paragrafi 1 pika l e Statutit të Statutit të Komunës, me nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, dhe kërkesa nga Ministria e Financave Nr. 928-1/2026 e datës 28.05.2026, Kryetari i Komunës së Vitisë paraqet këtë:

**PROPOZIM VENDIM
PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 01-110/05-490, TË DATËS 04.05.2026, PËR
KTHIMIN E MJETEVE BUXHETORE NË KATEGORINË EKONOMIKE TË
INVESTIMEVE KAPITALE**

Neni 1

Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës së Vitisë miratimin e Vendimit për shfuqizimin e Vendimit Nr. 01-110/05-490, të datës 04.05.2026, për kthimin e mjeteve buxhetore në kategorinë ekonomike të investimeve kapitale.

Neni 2

Shfuqizimi i këtij vendimi bëhet me kërkesë të Ministrisë së Financave, me Nr. 928-1/2026, të datës 28.05.2026.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Kryetari i Komunës:


Sokol Haliti